



International  
Labour  
Organization



MAP16

# ► Puna e fëmijëve në Kosovë: Hulumtim mbi shkaqet dhe pasojat e punës së fëmijëve

Nëntor 2022





## ▶ Puna e fëmijëve në Kosovë:<sup>1</sup> Hulumtim mbi shkaqet dhe pasojat e punës së fëmijëve

---

<sup>1</sup> Të gjitha referencat për Kosovën duhet të kuptohen në kontekstin e rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

E drejta e autorit © Organizata Ndërkombëtare e Punës 2022

Botuar për herë të parë në vitin 2022



Kjo është një vepër me qasje të hapur e shpërndarë nën licencën ndërkombëtare Creative Commons Attribution 4.0 (<https://creativecommons.org/licenses/by/4.0>). Përdoruesit mund të ripërdorin, bashkëndajnë, përshtatin dhe ndërtojnë veprën punën origjinale, siç detajohet në Licencë. ILO duhet të vlerësohet qartë si pronari i veprës origjinale. Përdorimi i emblemsë së ILO-së nuk lejohet në lidhje me punën e përdoruesve.

**Atribuimi** – Vepra duhet të citohet si vijon: FUNDAMENTALS, *Child labour in Kosovo: An enquiry into the causes and impact of child labour*, Geneva: International Labour Organization, 2022.

**Përkthimet** – Në rast të një përkthimi të kësaj vepre, së bashku me atributin duhet të shtohet edhe mohimi i mëposhtëm i përgjegjësishë: *Ky përkthim nuk është krijuar nga Zyra Ndërkombëtare e Punës (ILO) dhe nuk duhet të konsiderohet si përkthim zyrtar i ILO-së. ILO nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen ose saktësinë e këtij përkthimi.*

**Përshtatjet** – Në rast përshtatjeje të kësaj vepre, së bashku me atributin duhet të shtohet edhe mohimi i mëposhtëm i përgjegjësishë: *Kjo është një përshtatje e një vepre origjinale nga Zyra Ndërkombëtare e Punës (ILO). Përgjegjësia për pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në përshtatje i takon vetëm autorit ose autorëve të përshtatjes dhe nuk miratohen nga ILO.*

Të gjitha pyetjet mbi të drejtat dhe licencimin duhet të drejtohen tek ILO Publishing (Rights and Licensing), CH-1211 Geneva 22, Switzerland, ose me email në adresën [rights@ilo.org](mailto:rights@ilo.org).

---

ISBN: 978-92-2-038577-7 (Web PDF)

Gjithashtu në dispozicion në gjuhën angleze: *Child labour in Kosovo: An enquiry into the causes and impact of child labour*. ISBN: 978-92-2-038482-4 (Web PDF), Gjenevë, 2022.

në gjuhën serbe: *Zloupotreba dečjeg rada na Kosovu: Ispitivanje uzroka i efekata zloupotrebe dečjeg rada*. ISBN: 978-92-2-038578-4 (Web PDF), Gjenevë, 2022.

---

Emërtimet e përdorura në botimet e ILO-së, të cilat janë në përputhje me praktikën e Kombeve të Bashkuara, dhe prezantimi i materialit në to nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë mendimi nga ana e Zyrës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me statusin ligjor të çdo vendi, zone ose territori ose të autoriteteve të tij, ose në lidhje me përcaktimin e kufijve të tij.

Përgjegjësia për opinionet e shprehura në artikujt, studimet dhe kontributet e tjera të nënshkuara i takon vetëm autorëve të tyre dhe publikimi nuk përbën një miratim nga Zyra Ndërkombëtare e Punës për opinionet e shprehura në to.

Referimi i emrave të firmave dhe produkteve dhe proceseve komerciale nuk nënkupton miratimin e tyre nga Zyra Ndërkombëtare e Punës dhe çdo dështim për të përmendur një firmë të caktuar, produkt komercial ose proces nuk është shenjë mosmiratimi.

Informacionet mbi publikimet e ILO-së dhe produktet digjitale mund të gjenden në: [www.ilo.org/publns](http://www.ilo.org/publns).

---

## Mirënjohje

---

Ky publikim u përgatit nga znj. Donika Limani, Instituti i Diplomuar i Studimeve Ndërkombëtare dhe Zhvillimore, Konsulente për ILO, nën koordinimin e znj. Lindita Boshtrakaj nga ILO Budapest dhe z. Lorenzo Guarcello nga FUNDAMENTALS Zyra Gjenevë.

Financimi për këtë publikim të ILO-së sigurohet nga Departamenti i Punës i Shteteve të Bashkuara (USDOL) sipas marrëveshjes bashkëpunuese numër IL-30147-16-75-K-11 të Projektit “Matja, ndërgjegjësimi dhe përfshirja e politikave në përshpejtimin e veprimeve kundër punës së fëmijëve dhe punës së detyruar” (Projekti MAP16) (GLO/18/29/USA). Njëqind për qind e kostove totale të Projektit GLO/18/29/USA financohet me fonde federale, për një total prej 22,400,000 USD.

Ky publikim nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet ose politikat e USDOL dhe as përmendja e emrave tregtarë, produkteve komerciale ose organizatave nuk nënkupton miratim nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara.

---

[ilo.org/childlabour](http://ilo.org/childlabour)

Fotokompozuar nga Envinion, Pristina, Kosovo



## ► Përmbajtja

---

Shkurtesat dhe akronimet	x
Përmbledhje ekzekutive	xi
1. Hyrje	1
2. Përkufizimet dhe matja e punës së fëmijëve	3
3. Analiza përshkruese	7
3.1. Aktivitetet e kryera nga fëmijët	7
3.2. Faktorët e ekonomisë familjare dhe komunitetit që lidhen me punën e fëmijëve	14
3.3. Intensiteti kohor i punës së fëmijëve	18
3.4. Puna e fëmijëve dhe shkollimi	19
3.5. Ekspozimi ndaj rreziqeve të shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës	20
3.6. Punët e shtëpisë	24
4. Përcaktuesit e punës së fëmijëve: Analiza e regresionit	29
5. Implikimet e punës së fëmijëve në edukimin dhe shëndetin e tyre	33
5.1. Arsimi	33
5.2. Shëndeti	41
6. Konkluzioni	48
7. Rekomandimet	49
Referencat	50
Shtojca	51

## ► Tabelat

2.1. Përkufizimet statistikore për treguesit e punës së fëmijëve	5
3.1. Prevalenca e punës së fëmijëve për Kosovën në përgjithësi dhe për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	8
3.2. Përqindja e fëmijëve të përfshirë në punën e fëmijëve sipas grupmoshës, gjinisë, vendbanimit, rajonit dhe kuintilit të të ardhurave të ekonomisë familjare, në përgjithësi në Kosovë	9
3.3. Përqindja e fëmijëve në punën e fëmijëve, sipas grupmoshës, gjinisë, vendbanimit, rajonit dhe kuintilit të të ardhurave të ekonomisë familjare, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	10
3.4. Statusi i aktivitetit të fëmijës sipas gjinisë, rajonit dhe vendbanimit, grupmosha 5-14 vjeç, në përgjithësi në Kosovë	11
3.5. Statusi i aktivitetit të fëmijës sipas gjinisë, rajonit dhe vendbanimit, grupmosha 15-17 vjeç, në përgjithësi në Kosovë	12
3.6. Statusi i aktivitetit të fëmijës sipas gjinisë, rajonit dhe vendbanimit, grupmosha 5-14 vjeç, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	13
3.7. Statusi i aktivitetit të fëmijëve sipas gjinisë, rajonit dhe vendbanimit, grupmosha 15-17 vjeç, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	13
3.8. Intensiteti kohor i punës së fëmijëve: Orari mesatar javor i punës, sipas moshës, vendbanimit dhe gjinisë, në përgjithësi në Kosovë	18
3.9. Intensiteti kohor i punës së fëmijëve: Orari mesatar javor i punës, sipas moshës, vendbanimit dhe gjinisë, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	19
4.1. Probabiliteti për të qenë në punë të fëmijëve, efektet mesatare margjinale, në përgjithësi në Kosovë	30
4.2. Probabiliteti për të qenë në punë të fëmijëve, efektet mesatare margjinale, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	31
5.1. Probabiliteti i të pasurit të aftësive themelore të leximit, efektet mesatare margjinale, në përgjithësi në Kosovë	36
5.2. Probabiliteti i të pasurit të aftësive themelore të leximit, efektet mesatare margjinale, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	37
5.3. Probabiliteti për të pasur shkathtësi themelore të aritmetikës, efektet mesatare margjinale, në përgjithësi në Kosovë	39
5.4. Probabiliteti për të pasur shkathtësi themelore të aritmetikës, efektet mesatare margjinale, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	40
5.5. Probabiliteti për të pasur vështirësi funksionale, efektet mesatare margjinale, në përgjithësi në Kosovë	42
5.6. Probabiliteti për të pasur vështirësi funksionale, efekte mesatare margjinale, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	43
5.7. Probabiliteti i përjetimit të ankthit, efektet mesatare margjinale, në përgjithësi në Kosovë	44
5.8. Probabiliteti i përjetimit të ankthit, efektet mesatare margjinale, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	45
5.9. Probabiliteti i përjetimit të depresionit, efektet mesatare margjinale, në përgjithësi në Kosovë	46

5.10. Probabiliteti i përjetimit të depresionit, efektet mesatare marginale, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	47
A.1. Vlerësimet e popullatës të punës së fëmijëve, sipas moshës dhe gjinisë	55
A.2. Vëzhgimet e peshuara të punës së fëmijëve sipas moshës, gjinisë, vendbanimit, rajonit dhe kuintilit të indeksit të pasurisë, në përgjithësi në Kosovë	55
A.3. Vëzhgimet e peshuara të punës së fëmijëve sipas moshës, gjinisë, vendbanimit, rajonit dhe indeksit të pasurisë, komunitetet rom, egjiptian dhe ashkali	56
A.4. Statistikat përmbledhëse për variablat e përdorur në seksionin 4, në përgjithësi në Kosovë	57
A.5. Statistikat përmbledhëse për variablat e përdorur në seksionin 4, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	58

## ► Figurat

---

3.1. Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç në punë të fëmijëve, sipas kuintilit të pasurisë së ekonomisë familjare, privimeve materiale të ekonomisë familjare dhe gjinisë, në përgjithësi në Kosovë	14
3.2. Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç në punë të fëmijëve, sipas kuintilit të pasurisë së ekonomisë familjare, privimeve materiale të ekonomisë familjare dhe gjinisë, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	15
3.3. Puna e fëmijëve dhe niveli arsimor i kryefamiljarit, në përgjithësi në Kosovë	16
3.4. Puna e fëmijëve dhe niveli arsimor i kryefamiljarit, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	16
3.5. Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç në punën e fëmijëve, sipas nivelit arsimor dhe gjinisë së kryefamiljarit, në përgjithësi në Kosovë	16
3.6. Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç në punën e fëmijëve, sipas nivelit arsimor dhe gjinisë së kryefamiljarit, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	17
3.7. Shkalla e të qenit jashtë shkollës dhe puna e fëmijëve, fëmijët e moshës 6-17 vjeç, në përgjithësi në Kosovë	20
3.8. Shkalla e të qenit jashtë shkollës dhe puna e fëmijëve, fëmijët e moshës 6-17 vjeç, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	20
3.9. Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç të ekspozuar ndaj rreziqeve të shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës, sipas llojit të rrezikut dhe gjinisë, në përgjithësi në Kosovë	21
3.10. Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç të ekspozuar ndaj rreziqeve të shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës, sipas llojit të rrezikut dhe gjinisë, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	22
3.11. Kushtet e rrezikshme dhe puna e fëmijëve: Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç, në përgjithësi në Kosovë	23



3.12. Kushtet e rrezikshme dhe puna e fëmijëve: Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	23
3.13. Përqindja e fëmijëve që kryejnë punë të shtëpisë, sipas pragut të orëve, moshës dhe gjinisë, në përgjithësi në Kosovë	23
3.14. Përqindja e fëmijëve që kryejnë punë të shtëpisë, sipas pragut të orëve, moshës dhe gjinisë, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	25
3.15. Përqindja e fëmijëve të moshës 5-14 vjeç që kryejnë punë të shtëpisë për të paktën 21 orë në javë, sipas llojit të punës dhe gjinisë, në përgjithësi në Kosovë	26
3.16. Përqindja e fëmijëve të moshës 5-14 vjeç që kryejnë punë të shtëpisë së paku 21 orë në javë, sipas llojit të punës dhe gjinisë, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	26
3.17. Koha totale e shpenzuar nga fëmijët në punën e fëmijëve të moshës 5-14 vjeç në punën e fëmijëve dhe punët e shtëpisë, orët mesatare javore të punës, sipas moshës dhe gjinisë, në përgjithësi në Kosovë	27
3.18. Koha totale e shpenzuar nga fëmijët në punën e fëmijëve të moshës 5-14 vjeç në punën e fëmijëve dhe punët e shtëpisë, orët mesatare javore të punës, sipas moshës dhe gjinisë, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	28
5.1. Përfshirja e prindërve për fëmijët e moshës 7-14 vjeç, sipas statusit të punës së fëmijëve	34
5.2. Aftësitë e të lexuarit dhe puna e fëmijëve, fëmijët e moshës 7-14 vjeç, në përgjithësi në Kosovë	35
5.3. Aftësitë e të lexuarit dhe puna e fëmijëve, fëmijët e moshës 7-14 vjeç, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	35
5.4. Aftësitë e aritmetikës dhe puna e fëmijëve, fëmijët e moshës 7-14 vjeç, në përgjithësi në Kosovë	38
5.5. Aftësitë e aritmetikës dhe puna e fëmijëve, fëmijët e moshës 7-14 vjeç, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	38
5.6. Vështirësitë funksionale dhe puna e fëmijëve, fëmijët e moshës 5-17 vjeç, në përgjithësi në Kosovë	41
5.7. Vështirësitë funksionale dhe puna e fëmijëve, fëmijët e moshës 5-17 vjeç, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	41

## ► Kutia

1. Standardet ligjore dhe matëse në lidhje me punën e fëmijëve	4
--	---

## ► Shkurtesat dhe akronimet

---

<b>KDF</b>	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
<b>QPS</b>	Qendrat për Punë Sociale
<b>DPSF</b>	Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes
<b>PRRF</b>	Puna e rrezikshme e fëmijëve
<b>ICLS</b>	Konferenca Ndërkombëtare e Statisticienëve të Punës
<b>ILO</b>	Zyra/Organizata Ndërkombëtare e Punës
<b>ASK</b>	Agjencia e Statistikave të Kosovës
<b>LMF</b>	Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës
<b>MICS</b>	Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë
<b>OZHQ</b>	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
<b>SNA</b>	Sistemi i Llogarive Kombëtare
<b>OKB</b>	Kombet e Bashkuara
<b>UNICEF</b>	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

## ► Përmbledhje ekzekutive

Puna e fëmijëve mbetet fenomen shqetësues dhe i përhapur në mbarë globin. Sipas raportit të fundit (ILO dhe UNICEF 2021), një në dhjetë fëmijë në mbarë botën ishte i pëfshirë në punë të fëmijëve në fillim të vitit 2020. Vështirësitë e papritura të shkaktuara nga situata me COVID-19 kanë minuar më tej përparimin e bërë në luftën kundër punës së fëmijëve. Fatkeqësisht, Kosova nuk ka qenë krejtësisht immune ndaj kësaj çështjeje globale. Nuk është e pazakontë të shohësh fëmijë të Kosovës që kryejnë detyra të rrezikshme në rrugë apo tregje lokale, ose edhe duke lypur. Kjo situatë kërkon veprim të menjëhershëm në emër të shtetit dhe shoqërisë për të luftuar çështjen e punës së fëmijëve në Kosovë. Rrjedhimisht, ky raport synon të ndërrojë mendime dhe të informojë politikë-bërjen duke ofruar gjetjet më të fundit statistikore për këtë çështje. Më konkretisht, ai ofron një pasqyrë përshkruese të **prevalencës, përcaktuesve dhe pasojave** të punës së fëmijëve, bazuar në analizën përshkruese dhe të regresionit të Anketës së Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (MICS) 2019–20 të Kosovës.

Raporti konstaton se rreth 5.3 për qind e fëmijëve në Kosovë dhe 7 për qind e fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë në punë të fëmijëve. Një fëmijë tipik në punën e fëmijëve nga Kosova do të ishte një djalë i moshës 12 deri në 14 vjeç nga familjet më të varfra në zonat rurale të Ferizajt ose Gjilanit, ndërsa profili më i mundshëm i punës së fëmijëve në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian është një djalë i moshës 5 deri në 11 vjeç nga familjet e dyta më të varfra në zonat rurale. Rreth 96 për qind e fëmijëve të moshës 5 deri në 14 vjeç dhe 92 për qind e atyre të moshës 15 deri në 17 vjeç vijnë shkollën në Kosovë. Vetëm 1 për qind e fëmijëve të moshës 5 deri në 14 vjeç dhe 2 për qind e atyre të moshës 15 deri në 17 vjeç janë të angazhuar vetëm në aktivitet ekonomik. Por situata është jashtëzakonisht më e rëndë për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë: rreth 23 për qind e atyre të moshës 5 deri në 14 vjeç dhe 57 për qind e atyre të moshës 15 deri në 17 vjeç janë jashtë shkollës. Shumica e këtyre të fundit nuk janë as të angazhuar në ndonjë aktivitet ekonomik.

Fëmijët në ekonomitë familjare në kuintilin më të ulët të indeksit të pasurisë kanë më shumë gjasa të jenë në punë të fëmijëve sesa fëmijët e tjerë, ndërsa privimi material është më pak i ndërlidhur me punën e fëmijëve. Për dallim nga kjo, marrëdhëniet ndërmjet pasurisë së ekonomisë familjare, privimit material dhe punës së fëmijëve nuk janë të thjeshta për fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Sa i përket intensitetit të punës, fëmijët në punën e fëmijëve në Kosovë kalojnë mesatarisht 10.3 orë duke punuar në javë. Për dallim nga kjo, fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë punojnë pothuajse dy herë më shumë se mesatarja kombëtare, me 18.6 orë në javë. Intensiteti kohor i punës së fëmijëve dhe përfshirja në punët e shtëpisë përkeqësohet teksa fëmijët rriten. Vajzat kanë shumë më shumë gjasa të angazhohen në punët e shtëpisë sesa djemtë dhe për më shumë orë.

Situata për sa i përket rreziqeve në vendin e punës është më pak shqetësuese. Vetëm 2.7 për qind e fëmijëve janë të ekspozuar ndaj kushteve të rrezikshme në vendin e punës në përgjithësi në Kosovë. Megjithatë, kjo shifër rritet ndjeshëm kur fokusohemi vetëm tek fëmijët në punën e fëmijëve, me rreth 18.2 për qind të fëmijëve në përgjithësi në Kosovë dhe 34.7 për qind të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë.

Statistikat e përgjithshme përshkruese të përshkruara në paragrafët e mësipërm konfirmohen më tej nga analiza ekonometrike mbi përcaktuesit e punës së fëmijëve. Analiza e regresionit zbuloi se përcaktuesit statistikisht të rëndësishëm të punës së fëmijëve për fëmijët e Kosovës janë mosha, të qenit djalë, të qenurit nga zonat rurale dhe përkatësia etnike shqiptare. Vështirësitë funksionale të prindërve apo kujdestarëve ishin një faktor shtesë përcaktues i punës së fëmijëve për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë.

Raporti gjithashtu merr në konsideratë implikimet e punës së fëmijëve për cilësitë arsimore dhe shëndetësore të fëmijëve të moshës 7 deri në 14 vjeç. Analiza e regresionit zbuloi se të qenit në punën e fëmijëve lidhet me një ulje prej 6.7

pikë përqindjeje në probabilitetin për të pasur shkathtësi themelore të leximit duke marrë parasysh dallimet në karakteristika individuale dhe të ekonomive familjare. Megjithatë, nuk kishte ndikim statistikisht të rëndësishëm për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë. Për më tepër, puna e fëmijëve lidhet gjithashtu me një rënie prej 6.7 pikë përqindjeje në probabilitetin e një fëmije për të pasur shkathtësi themelore aritmetike gjithmonë duke marrë parasysh dallimet në karakteristika individuale dhe të ekonomive familjare. Pasojat e punës së fëmijëve në probabilitetin për të pasur shkathtësi themelore aritmetikësaritmetike janë edhe më të dukshme për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (9.5 pikë përqindje).

Në fund, raporti zbulon se puna e fëmijëve nuk ka një lidhje statistikisht të rëndësishme me vështirësitë funksionale pasi merren parasysh të gjitha dallimet individuale dhe familjare. Çuditërisht, të qenit në punën e fëmijëve lidhet me një rënie prej 4.3 pikë përqindjeje të probabilitetit që fëmijët të vuajnë nga ankthi në përgjithësi në Kosovë, ndërsa nuk ka asnjë efekt statistikisht të rëndësishëm të fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Përveç kësaj, nuk gjetëm një lidhje statistikisht të rëndësishme ndërmjet punës së fëmijëve dhe depresionit, as për fëmijët në përgjithësi në Kosovë, as për ata nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Raporti paraqet një pasqyrë më të qartë të karakteristikave të fëmijëve në punën e fëmijëve dhe atyre në rrezik në Kosovë. Ç'është më e rëndësishmja, këto gjetje vërtetojnë më tej efektin e dëmshëm të punës së fëmijëve në përparimin arsimor të fëmijëve. Si të tilla, ato janë një thirrje për Qeverinë, shoqërinë civile dhe palët e tjera të interesuara që të ndërmarrin veprime për të eliminuar punën e fëmijëve dhe për të përmirësuar rezultatet arsimore të fëmijëve.

---

►► Në fund, raporti zbulon se puna e fëmijëve nuk ka një lidhje statistikisht të rëndësishme me vështirësitë funksionale pasi merren parasysh të gjitha dallimet individuale dhe familjare. Çuditërisht, të qenit në punën e fëmijëve lidhet me një rënie prej 4.3 pikë përqindjeje të probabilitetit që fëmijët të vuajnë nga ankthi në përgjithësi në Kosovë, ndërsa nuk ka asnjë efekt statistikisht të rëndësishëm të fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Përveç kësaj, nuk gjetëm një lidhje statistikisht të rëndësishme ndërmjet punës së fëmijëve dhe depresionit, as për fëmijët në përgjithësi në Kosovë, as për ata nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

## ► 1. Hyrje

Ka ende tepër shumë fëmijë të prekur nga puna e fëmijëve në mbarë globin, duke rrezikuar si perspektivën e tyre ashtu edhe tonën si shoqëri. Sipas vlerësimeve më të fundit globale (ILO dhe UNICEF 2021), pothuajse një në dhjetë fëmijë në mbarë botën u klasifikuan si në punë të fëmijëve në fillim të vitit 2020. Kjo shifër përkthehet në 160 milionë fëmijë, 63 milionë vajza dhe 97 milionë djem. Nga ky grup, rreth gjysma e tyre janë në kushte edhe më të pasigurta, zakonisht të përfshirë në punë të rrezikshme që rrezikojnë shëndetin, sigurinë dhe zhvillimin moral të tyre. Për më tepër, situata me COVID-19 ka minuar më tej përparimin e bërë në luftën kundër punës së fëmijëve në mungesë të veprimeve zbutëse në kohë. Fatkeqësisht, Kosova nuk është plotësisht immune ndaj kësaj çështjeje globale. Për më tepër, një pjesë jo e papërfillshme e fëmijëve kosovarë gjithashtu janë ekspozuar ndaj formave më të këqija të punës së fëmijëve, të cilat përfshijnë shfrytëzimin komercial seksual (USDOL 2020).

Megjithatë, ka pasur njëfarë progresi në kornizën institucionale dhe ligjore të Kosovës lidhur me këtë çështje në vitet e kaluara. Për shembull, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (LMF) ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2020. Ai ndalon të gjitha format e abuzimit dhe shfrytëzimit që rrezikojnë jetën, sigurinë, shëndetin, arsimimin, trajnimin dhe zhvillimin e fëmijës. Kapitulli 4 i ligjit trajton në mënyrë specifike mbrojtjen e

fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, duke ndaluar punësimin e fëmijëve në aktivitete që dëmtojnë sigurinë, shëndetin, moralin dhe zhvillimin psikofizik të tyre. Që atëherë janë hartuar rregullore të shumta për zbatimin e LMF-së, duke përfshirë një version të përditësuar të Listës së Punëve të Rrezikshme të Fëmijëve<sup>1</sup> si dhe Procedurat Standarde të Operimit për Fëmijët në Punë të Rrezikshme të Fëmijëve.<sup>2</sup> Për më tepër, një bazë e të dhënave për menaxhimin digjital të rasteve të punës së fëmijëve u krijua me mbështetjen e ILO-s në kuadër të projektit të saj MAP16 (Masat, ndërgjegjësimi dhe përfshirja e politikave në përsheptimin e veprimeve kundër punës së fëmijëve dhe punës së detyruar) dhe u lansua zyrtarisht nga Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes (DPSF) më 15 mars 2021, duke zëvendësuar modulën e mëparshëm për punën e fëmijëve në bazën e të dhënave të shërbimeve sociale. Krahas digjitalizimit të procesit të menaxhimit të rasteve, ai mundëson edhe gjenerimin e raporteve bazuar në treguesit e zhvilluar për monitorimin e punës së fëmijëve. Gjithashtu është zhvilluar kapaciteti për shumë përdorues i aplikacionit, duke mundësuar kapacitetin e përbashkët të të gjitha moduleve (aktuale dhe të ardhshme) të Platformës së Shërbimeve të Integruara Sociale, ndërsa funksioni i ndërveprueshmërisë e bën modulën e punës së fëmijëve të aftë për t'u lidhur me institucione të tjera dhe për të marrë të dhëna përkatëse. Është forcuar kapaciteti i Qendrave për

<sup>1</sup> Në përputhje me Konventën nr.182 të ILO-s për format më të rënda të punës së fëmijëve, 1999, tre kategoritë e para të formave më të rënda të punës së fëmijëve (trafikimi i fëmijëve, puna e detyruar, rekrutimi i fëmijëve për përdorim në konflikt të armatosur, përdorimi i fëmijëve për prostitucion dhe pornografi dhe përdorimi i fëmijëve për aktivitete të paligjshme) në Kosovë janë të ndaluara me Kodin Penal. Sa i përket kategorisë së katërt, është përcaktuar si punë e rrezikshme e fëmijëve në Kosovë, me mbështetjen e ILO-s gjatë viteve 2005–07 dhe lista e punëve të rrezikshme të fëmijëve është zbatuar ligjërisht si Udhëzim Administrativ i Qeverisë për Parandalimin dhe Eliminimin e Menjëhershëm të Punëve të Rrezikshme për Fëmijët (UA 17/2008). Udhëzimi Administrativ liston (a) sektorët e rrezikshëm; dhe (b) aktivitetet gjenerike të rrezikshme që duhet të ndalohen si çështje prioritare; në vitin 2013, UA 17/2008 u zëvendësua me UA 05/2013, duke përditësuar listën e punëve të rrezikshme të fëmijëve në Kosovë.

<sup>2</sup> Si dokument zyrtar, që rrjedh nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve, Procedurat Standarde Operative (PSO) synojnë të përmirësojnë zbatimin e ligjeve dhe politikave që lidhen me punën e fëmijëve dhe të forcojnë bashkëpunimin multidisiplinar për të mbrojtur fëmijët nga puna e rrezikshme e fëmijëve (PRRF). Ato përcaktojnë dhe institucionalizojnë rolet dhe procedurat operative të institucioneve në nivel qendror dhe komunal për parandalimin, identifikimin, mbledhjen e të dhënave, referimin dhe trajtimin e fëmijëve të përfshirë në PRRF. PSO-të u zhvilluan me mbështetjen e ILO-s në kuadër të projektit MAP16 dhe u miratuan zyrtarisht nga Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes- MFLT në qershor të vitit 2021.

Punë Sociale (QPS) në mbarë Kosovën për menaxhimin e rasteve të fëmijëve që janë viktime të punës së fëmijëve; një udhëzues, udhëzime dhe materiale mbështetëse janë gjithashtu në dispozicion në tri gjuhë zyrtare për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të QPS-ve. Janë bërë gjithashtu përpjekje për të forcuar reagimin e arsimit, bujqësisë dhe institucioneve të zbatimit të ligjit në trajtimin e punës së fëmijëve, duke përfshirë një përmirësim të Modullit për Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit në Arsim për të mundësuar raporte në kohë reale për numrin e fëmijëve që kombinojnë shkollën dhe punën.

Përkundër këtij progresi, hulumtimet të mirëfillta për të shtyrë përpara luftën kundër punës së fëmijëve në Kosovë mbeten të pakta (shih, për shembull, ILO 2020; GRETA 2021). Raportet e detajuara të anketës MICS të kryera nga UNICEF-i dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës ofrojnë informacionet më të fundit mbi punën e fëmijëve (UNICEF dhe ASK 2020a, 2020b). Megjithatë, duke qenë se ato fokusohen në një gamë të gjerë të temave që lidhen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të fëmijëve (OZHQ), ato nuk thellohen në mënyrë specifike mbi punën e fëmijëve. Ky raport synon të plotësojë këtë boshllëk duke përdorur të dhënat e viteve 2019–2020 nga këto dy raporte. Duke vepruar kështu, ai rrit ndërgjegjësimin dhe ofron dëshmi të forta për të ndihmuar në luftën kundër punës së fëmijëve. Këto anketa ofrojnë të dhëna statistikisht të besueshme dhe të krahasueshme ndërkombëtare isht për zhvillimin e politikave dhe programeve të bazuara në dëshmi dhe monitorimin e progresit drejt qëllimeve kombëtare dhe angazhimeve globale.

Objektivi i këtij raporti është të sigurojë dëshmi të fuqishme statistikore mbi karakteristikat që lidhen me punën e fëmijëve, përcaktuesit e punës së fëmijëve dhe ndikimin e punës së fëmijëve në rezultatet arsimore dhe shëndetësore të fëmijëve, duke kryer një sërë tabelimesh tërthore dhe regresionesh mbi grupet e të dhënave të MICS 2019–20. Rezultatet janë raportuar veçmas për Kosovën në përgjithësi dhe për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, pasi që dizajni i anketës dhe peshimi ndryshojnë.

Raporti fillon duke dhënë një pasqyrë të përkufizimeve dhe matjeve të punës së fëmijëve (seksioni 2). Seksioni 3 i kushtohet një analize përshkruese të prevalencës së punës së fëmijëve në Kosovë. Më pas, seksioni 4 shqyrton analizën e regresionit të përcaktuesve të punës së fëmijëve dhe pasohet nga një përmbledhje e pasojave të punës së fëmijëve në arsimin dhe shëndetin e tyre në seksionin 5. Në fund, raporti paraqet përfundimet kryesore dhe rekomandimet e ardhshme në seksionin 6 dhe 7.

---

►► Ka ende tepër shumë fëmijë të prekur nga puna e fëmijëve në mbarë globin, duke rrezikuar si perspektivën e tyre ashtu edhe tonën si shoqëri. Sipas vlerësimeve më të fundit globale (ILO dhe UNICEF 2021), pothuajse një në dhjetë fëmijë në mbarë botën u klasifikuan si në punë të fëmijëve në fillim të vitit 2020. Kjo shifër përkthehet në 160 milionë fëmijë, 63 milionë vajza dhe 97 milionë djem. Nga ky grup, rreth gjysma e tyre janë në kushte edhe më të pasigurta, zakonisht të përfshirë në punë të rrezikshme që rrezikojnë shëndetin, sigurinë dhe zhvillimin moral të tyre.

## ► 2. Përkufizimet dhe matja e punës së fëmijëve

Ky seksion përshkruan konceptet ligjore dhe statistike të punës së fëmijëve nga pikëpamja ndërkombëtare dhe kombëtare. Ai gjithashtu ofron më shumë detaje se si matet puna e fëmijëve në këtë raport bazuar në anketën e MICS.

Puna e fëmijëve i referohet punës për të cilën fëmijët janë ose shumë të vegjël ose që mund të jetë e dëmshme fizikisht ose psikologjikisht për shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Tri Konventat kryesore ndërkombëtare – Konventa e Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Fëmijës (KDF), Konventa (nr. 138) e ILO-s për moshën minimale, 1973, si dhe konventa (nr. 182) për format më të rënda të punës së fëmijëve, 1999 – së bashku vendosin kufijtë ligjorë për punën e fëmijëve dhe sigurojnë bazat ligjore për veprime kombëtare dhe ndërkombëtare kundër saj. Për më tepër, rezoluta IV e Konferencës së 20-të Ndërkombëtare të Statisticienëve të Punës (ICLS) përcakton kornizën referuese për matjen dhe statistikat e punës së fëmijëve (shih kutinë 1).

Ratifikimi i këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare nuk është i thjeshtë për Kosovën, duke pasur parasysh statusin e saj unik kundrejt Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, neni 22 i Kushtetutit të Kosovës e inkorporon KDF-në e OKB-së në kornizën e saj ligjore kombëtare. Ajo gjithashtu ka një sërë ligjesh që rregullojnë çështjet e punës së fëmijëve. Moshë minimale e punës në Kosovë është 15 vjeç, siç përcaktohet në nenin 7 të Ligjit të Punës, ndërsa moshë minimale e punës për punë të rrezikshme është 18 vjeç, siç përcaktohet në nenet 20, 23, 26-27 dhe 45 të Ligjit të Punës. Lista e profesioneve dhe aktiviteteve të rrezikshme të ndaluara për fëmijët është e specifikuar në Udhëzimin Administrativ nr. 05/2013; Nenin 45 të Ligjit të Punës; Udhëzimin Administrativ nr. 2008 (32-34).

UNICEF-i zhvilloi Programin Global të MICS në vitet e 1990-ta si një program ndërkombëtar shumëqëllimor i anketimit të ekonomive familjare për të mbështetur vendet në mbledhjen e të dhënave të krahasueshme ndërkombëtarisht për një gamë të gjerë treguesish mbi situatën e fëmijëve dhe grave. Anketat e MICS matin treguesit kryesorë që u lejojnë vendeve të gjenerojnë të dhëna për përdorim në politika, programe

dhe plane kombëtare të zhvillimit dhe të monitorojnë progresin drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe angazhimeve të tjera të dakorduara ndërkombëtarisht.

Një tregues i rëndësishëm i OZHQ-ve për qëllimet tona është ai në lidhje me punën e fëmijëve, OZHQ 8.7.1. Përkufizimet e përshkuara në kutinë 1 theksojnë aktivitetet e rrezikshme si një komponent i punës së fëmijëve. Megjithatë, përkufizimi i OZHQ-së dhe, rrjedhimisht, anketa e MICS ka një qasje tjetër. Treguesi 8.7.1 i OZHQ-ve përdor punën përtej pragjeve për orë që janë specifike për moshën, si një përafrim (“proxy”) për punën e rrezikshme për të siguruar krahasueshmërinë e vlerësimeve dhe për të minimizuar çështjet e cilësisë së të dhënave. Në fund, versioni i parë i këtij treguesi e konsideron prodhimin e mallrave për përdorim vetanak ose aktivitetet e tilla si shkuarjen për të marrë ujë si punë shtëpiake. Kjo do të thotë se ato ndodhen jashtë kufirit të prodhimit të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA) të Kombeve të Bashkuara. Prandaj, duhet mbajtur mend se bazuar në standardet statistike të përcaktuara në rezolutën ICLS, vlerësimet e punës së fëmijëve përfaqësojnë standarde të dobishme për qëllime krahasuese ndërkombëtare, por nuk janë domosdoshmërisht në përputhje me vlerësimet e legjislacionit kombëtar të punës së fëmijëve

►► UNICEF-i zhvilloi Programin Global të MICS në vitet e 1990-ta si një program ndërkombëtar shumëqëllimor i anketimit të ekonomive familjare për të mbështetur vendet në mbledhjen e të dhënave të krahasueshme ndërkombëtarisht për një gamë të gjerë treguesish mbi situatën e fëmijëve dhe grave.

### Kutia 1. Standardet ligjore dhe matëse në lidhje me punën e fëmijëve

**Konventa (nr. 138) e ILO-s për moshën minimale, 1973** u bën thirrje Shteteve Anëtare të caktojnë një moshë minimale të përgjithshme për pranim në punë ose punësim jo më të ulët se fundi i arsimit të detyrueshëm, dhe përgjithësisht të paktën 15 vjeç (neni 2, paragrafi 3), dhe një moshë minimale më të lartë prej jo më pak se 18 vjeç për punësim ose punë e cila nga natyra e saj ose rrethanat në të cilat kryhet ka të ngjarë të rrezikojë shëndetin, sigurinë ose moralin e të rinjve – zakonisht të referuara si punë e rrezikshme (neni 3, para. 1).

Megjithatë, nuk ka një listë ndërkombëtare të punëve të rrezikshme. Prandaj, identifikimi i llojeve të rrezikshme të punësimit ose punës të ndaluar deri në 18 vjeç duhet të përcaktohet nga autoriteti kombëtar kompetent pas konsultimit me organizatat e punëdhënësve dhe të punonjësve (neni 3, paragrafi 2). Konventa përmban gjithashtu disa klauzola fleksibiliteti që janë lënë në diskrecionin e autoritetit kombëtar kompetent në konsultim me organizatat e punonjësve dhe punëdhënësve. Këto përfshijnë klauzola në lidhje me moshën minimale dhe punën e lehtë:

(a) *Mosha minimale*. Members whose economy and educational facilities are insufficiently developed may specify a lower general minimum age of 14 years (Art. 2, para. 4), although some choose to set it at 16 years.

(b) *Puna e lehtë*. Ligjet ose rregulloret kombëtare mund të lejojnë punësimin ose punën e personave 13 deri në 15 vjeç që (i) nuk ka gjasa të jetë e dëmshme për shëndetin ose zhvillimin e tyre; dhe (ii) jo të tilla që të cenojnë vijueshmërinë e tyre në shkollë, pjesëmarrjen e tyre në programet e orientimit profesional ose trajnimit të miratuara nga autoriteti kompetent ose aftësinë e tyre për të përfituar nga mësimet e marra (neni 7). Kufiri më i ulët i moshës për punë të lehta mund të jetë 12 vjeç për vendet në zhvillim (neni 7, paragrafi 4).

**Konventa (nr. 182) e ILO-s për format më të rënda (këqija) të punës së fëmijëve, 1999** plotëson Konventën nr. 138 duke theksuar fokusin urgjent në format më të rënda të punës së fëmijëve që kërkojnë veprim të menjëhershëm. Për qëllimet e Konventës, format më të rënda të punës së fëmijëve përfshijnë:

- a) të gjitha format e skllavërisë ose praktikave të ngjashme me të, si shitja dhe trafikimi i fëmijëve, robëria dhe bujkrobëria për shkak të borxheve, si dhe puna e detyruar apo e detyrueshme, duke përfshirë rekrutimin e detyruar apo të detyrueshëm të fëmijëve për t'i angazhuar në konflikt të armatosur;
- b) përdorimi, sigurimi ose ofrimi i fëmijës për prostitucion, për prodhimin e materialeve pornografike ose për shfaqje pornografike;
- c) përdorimi, sigurimi ose ofrimi i fëmijës për veprimtari të paligjshme, veçanërisht për prodhimin dhe trafikimin e narkotikëve, siç përcaktohet në traktatet përkatëse ndërkombëtare; dhe
- d) puna e cila, nga natyra ose rrethanat në të cilat kryhet, mund të dëmtojë shëndetin, sigurinë ose moralin e fëmijëve (neni 3) ("punë e rrezikshme"). **Rekomandimi nr.190 i ILO-s** ofron udhëzime më të detajuara për vendet për të përkufizuar punën e rrezikshme brenda kufijve të tyre.

**Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës e vitit 1989** njeh të drejtën e fëmijës për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rreziqe ose që cënon edukimin e fëmijës, ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror (neni 32.1). Për të arritur këtë qëllim, KDF-ja u bën thirrje Shteteve Palë të përcaktojnë moshat minimale për pranim në punë, duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të instrumenteve të tjera ndërkombëtare (neni 32.2).

**Rezoluta IV** e Konferencës së 20-të Ndërkombëtare të Statisticienëve të Punës përbën standardin autoritativ për matjen e punës së fëmijëve. Ajo ofron udhëzime për përkthimin e standardeve ligjore ndërkombëtare në lidhje me matjen e punës së fëmijëve në terma statistikorë për qëllime të matjes së punës së fëmijëve. Ai thotë se puna e fëmijëve mund të matet në termat e angazhimit të fëmijëve në aktivitetet e punës bazuar në kufirin e përgjithshëm të prodhimit ose në kufirin e prodhimit të përkthuar në **Sistemin e Llogarive Kombëtare të OKB-së (SNA)**.



Raportet e Anketës së Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2019–2020 për Kosovën në përgjithësi dhe për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë (UNICEF dhe ASK 2020a, 2020b) paraqesin informacione të përditësuara për vlerësimin e kushteve socio-ekonomike të grave dhe fëmijëve dhe situatës demografike. Moduli i punës së fëmijëve lejon konstruktimin e treguesit 8.7.1 të OZHQ-ve (me dhe pa punët e shtëpisë) dhe një treguesi tjetër MICS6, i cili përfshin disa përkufizime të punës së rrezikshme. Raportet e MICS zgjedhën të raportonin versionin që përfshin punët e shtëpisë si vlerësim kombëtar i punës së fëmijëve (OZHQ 8.7.1 – Treguesi 2). Prandaj, ky raport përdor edhe përkufizimin e fundit për treguesin e punës së fëmijëve gjatë gjithë analizës. Rezultatet raportohen veçmas për Kosovën në përgjithësi dhe për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë pasi që dizajni i anketës dhe peshat rezultuese ndryshojnë. Tabela 2.1 përshkruan përkufizimet e ndryshme statistikore për një pasqyrë të plotë.

► **Tabela 2.1. Përkufizimet statistikore për treguesit e punës së fëmijëve**

Treguesi i punës së fëmijëve	Përkufizimi statistikor
<b>Përkufizimi i përdorur në vlerësimet globale të ILO-s për punën e fëmijëve</b>	<p>Përqindja e fëmijëve që kanë kryer aktivitete ekonomike gjatë javës së fundit për më shumë se numri i orëve specifike për moshën ose duke bërë punë të rrezikshme siç specifikohet më poshtë:</p> <p>mosha 5-17 vjeç: i punësuar në punë të rrezikshme (në profesione ose industri të rrezikshme)</p> <p>mosha 5-11 vjeç: 1 orë ose më shumë</p> <p>mosha 12-14: 14 orë ose më shumë</p> <p>mosha 15-17: 43 orë ose më shumë</p>
<b>Treguesi 8.7.1 i OZHQ-ve – Treguesi 1</b>	<p>Përqindja e fëmijëve që kanë kryer aktivitete ekonomike gjatë javës së fundit për më shumë se numri i orëve specifike për moshën klasifikohet si në punën e fëmijëve:</p> <p>mosha 5-11 vjeç: 1 orë ose më shumë</p> <p>mosha 12-14: 14 orë ose më shumë</p> <p>mosha 15-17: 43 orë ose më shumë</p>
<b>Treguesi 8.7.1 i OZHQ-ve – Treguesi 2</b>	<p>Përqindja e fëmijëve që kanë kryer:</p> <p>aktivitete ekonomike gjatë javës së fundit për më shumë se numri i orëve specifike për moshën klasifikohen si në punën e fëmijëve:</p> <p>mosha 5-11 vjeç: 1 orë ose më shumë</p> <p>mosha 12-14: 14 orë ose më shumë</p> <p>mosha 15-17: 43 orë ose më shumë</p> <p>punët e shtëpisë gjatë javës së fundit për më shumë se numri i orëve specifike për moshën klasifikohen si në punën e fëmijëve:</p> <p>mosha 5-14 vjeç: 21 orë ose më shumë</p>
<b>Treguesi MICS6</b>	<p>Përqindja e fëmijëve të përfshirë në aktivitete ekonomike ose punët e shtëpisë mbi pragjet (siç është paraqitur më sipër), ose që punojnë në kushte të rrezikshme</p>



## ► 3. Analiza përshkruese

---

Ky seksion përshkruan karakteristikat kryesore demografike dhe ekonomike të popullsisë së fëmijëve në punën e fëmijëve. Ai shqyrton kryesisht korrelacionet midis punës së fëmijëve dhe faktorëve të ndryshëm si prejardhja e tyre socio-ekonomike, arsimit dhe shëndeti. Këto tipare mund të jenë njëkohësisht faktor rreziku dhe pasojë e punës së fëmijëve. Prandaj, të kuptuarit e korrelacioneve midis këtyre tipareve dhe punës së fëmijëve është thelbësore për të ditur se cilat grupe dhe cilat veçori duhet të jenë fokusi i politikave që luftojnë punën e fëmijëve.

Analiza fillon me përshkrimin e aktiviteteve të kryera nga fëmijët. Nënseksioni vijues shqyrton më pas faktorët e familjes dhe komunitetit që lidhen me punën e fëmijëve. Më pas, raporti thellohet në intensitetin kohor të punës së fëmijëve, për të kaluar më pas në lidhjen e tij me shkollën, sëmundjet dhe punët e shtëpisë.

### 3.1. Aktivitetet e kryera nga fëmijët

Është jetike që fillimisht të kuptohet se sa fëmijë janë të prekur nga puna e fëmijëve në Kosovë (domethënë shkalla e prevalencës). Duke pasur parasysh përkufizimet e shumta të punës së fëmijëve, ky seksion ofron statistikën sipas secilit prej tyre për një pamje të plotë të paanshme. Fatkeqësisht, peshat e prodhuara nga anketat e MICS marrin parasysh vetëm dizajnin e përzgjedhjes së fëmijëve brenda ekonomisë familjare dhe nuk lejojnë gjenerimin e vlerësimeve të popullsisë. Megjithatë, duke përdorur parashikimet e popullsisë të Divizionit të Popullsisë të OKB-së, një vlerësim i papërpunuar i popullsisë për numrin e fëmijëve të prekur mund të llogaritet duke shumëzuar vlerësimet e anketës me madhësinë e popullsisë.

Tabela 3.1 tregon se 5.3 përqind e fëmijëve (19,642) në Kosovë konsiderohen të jenë në punë të fëmijëve sipas treguesit të dytë të 8.7.1 të OZHQ-ve. Kjo shifër është pak më e lartë për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, në 7 përqind (534). Megjithatë, nëse puna në punët e shtëpisë nuk merret parasysh (treguesi i parë 8.7.1. i OZHQ-ve), vetëm 3.8 përqind e fëmijëve në përgjithësi në Kosovë (14,083) dhe 6.1 përqind e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë (465) janë të prekur. Një tregues tjetër i përdorur edhe nga anketa MICS – MICS6 – merr në konsideratë orët dhe kushtet e punës së aktiviteteve ekonomike dhe shtëpiake të fëmijëve. Bazuar në këtë tregues, prevalenca e punës së fëmijëve pothuajse u dyfishua nga 5.3 në 9.3 përqind për Kosovën në përgjithësi (19,642 në 34,467). Gjithashtu është rritur nga 7 në 9 përqind për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë (534 në 686). Tabela thekson rëndësinë e punëve të shtëpisë dhe kushteve të rrezikshme në matjen e punës së fëmijëve. Megjithatë, pjesa tjetër e këtij raporti përcakton punën e fëmijëve bazuar në treguesin e dytë të 8.7.1 të OZHQ-ve për qëllime të krahasueshmërisë.

► **Tabela 3.1. Prevalenca e punës së fëmijëve për Kosovën në përgjithësi dhe për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**

Treguesi i punës së fëmijëve	Përkufizimi statistikor	Kosova	Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian		
<b>Treguesi 8.7.1 i OZHQ-ve – Treguesi 2</b>	Përqindja e fëmijëve që kanë kryer: aktivitete ekonomike gjatë javës së fundit për më shumë se numri i orëve specifike për moshën klasifikohet si në punën e fëmijëve: mosha 5-11 vjeç: 1 orë ose më shumë	5.3%	19 642	7%	534
	mosha 12-14: 14 orë ose më shumë				
	mosha 15-17: 43 orë ose më shumë				
	punët e shtëpisë gjatë javës së fundit për më shumë se numri i orëve specifike për moshën klasifikohet si në punën e fëmijëve: mosha 5-14 vjeç: 21 orë ose më shumë				
<b>Treguesi 8.7.1 i OZHQ-ve – Treguesi 1</b>	Përqindja e fëmijëve që kanë kryer aktivitete ekonomike gjatë javës së fundit për më shumë se numri i orëve specifike për moshën klasifikohet si në punën e fëmijëve: mosha 5-11 vjeç: 1 orë ose më shumë	3.8%	14 083	6.1%	465
	mosha 12-14: 14 orë ose më shumë				
	mosha 15-17: 43 orë ose më shumë				
<b>Treguesi i MICS6</b>	Përqindja e fëmijëve të përfshirë në aktivitete ekonomike ose punët e shtëpisë mbi pragjet (siç është paraqitur më sipër), ose që punojnë në kushte të rrezikshme	9.3%	34 467	9%	686

*Shënim: Kushtet e rrezikshme përfshijnë: bartjen e ngarkesave të rënda; punën me mjete të rrezikshme ose përdorimin e makinerive të rënda; ekspozimi ndaj pluhurit, tymrave ose gazit; ekspozimi ndaj të ftohtit ekstrem, nxehtësisë ose lagështisë; ekspozimi ndaj zhurmës së lartë ose dridhjeve; punën në lartësi; punën me kimikate ose eksplozivë; ekspozimi ndaj gjërave, proceseve ose kushteve të tjera të pasigurta ose të pashëndetshme.*

Shkalla e prevalencës ndryshon ndjeshëm sipas gjinisë, vendbanimit, rajonit dhe pasurisë së ekonomisë familjare. Tabela 3.2 përmbledh pjesën e punës së fëmijëve në secilën prej këtyre shtresave të ndryshme. Është e nevojshme të theksohet numri i vëzhgimeve të anketës për punën e fëmijëve në grupmosha dhe karakteristika të ndryshme. Për shembull, tabelat A.2 dhe A.3 në Shtojcë tregojnë shumë pak vëzhgime të punës së fëmijëve në kategorinë e moshës 15-17 vjeç. Kështu, interpretimi i asaj kolone në tabelën 3.2 për atë grupmoshë duhet shikuar me rezerva.

Përqindja më e lartë e fëmijëve në punën e fëmijëve është për grupmoshën 12-14 vjeç (7.9 për qind) në krahasim me fëmijët më të vegjël (6.4 për qind) dhe më të rriturit (1.1 për qind). Në përgjithësi, fëmijët në punën e fëmijëve kanë pak më shumë gjasa të jenë djem (6.4 për qind) sesa vajza (4.1 për qind). Puna e fëmijëve është dy herë më e përhapur në zonat rurale (6.8 për qind) sesa në zonat urbane (3.2 për qind). Fëmijët nga rajoni i Ferizajt (7.8 për qind) dhe Gjilanit (6.8 për qind) janë gjithashtu më të ekspozuar ndaj punës së fëmijëve sesa ata në pesë regjionet e tjera të Kosovës. Në fund, siç pritej, përqindja më e lartë e fëmijëve në punën e fëmijëve (7.9 për qind) mund të shihet në ato me bazë në ekonomitë familjare më të varfra, të përafuara me kuintilin më të ulët të indeksit të pasurisë. Prandaj, profili më i mundshëm i fëmijës punëtor në Kosovë është një djalë i moshës 12 deri në 14 vjeç nga ekonomitë familjare më të varfra në zonat rurale të Ferizajt apo Gjilanit.

► **Tabela 3.2. Përqindja e fëmijëve në punën e fëmijëve, sipas grupmoshës, gjinisë, vendbanimit, rajonit dhe kuintilit të të ardhurave të ekonomisë familjarë, në përgjithësi në Kosovë**

		Grupmosha			Gjithsej fëmijë
		Fëmijët e moshës 5-11 vjeç (%)	Fëmijët e moshës 12-14 vjeç (%)	Fëmijët e moshës 15-17 vjeç (%)	5-17 vjeç (%)
<b>Gjinia</b>	Mashkull	7.8	9.3	1.1	6.4%
	Femër	5.0	6.4	0.0	4.1%
<b>Vendbanimi</b>	Urban	4.7	2.7	0.2	3.2%
	Rural	7.7	10.8	0.8	6.8%
<b>Rajoni</b>	Gjakovë	4.4	11.1	0.0	4.4%
	Gjilan	7.4	10.7	1.0	6.8%
	Mitrovicë	7.0	1.1	0.0	3.9%
	Pejë	4.8	7.6	2.3	5.0%
	Prizren	2.3	9.9	2.0	4.0%
	Prishtinë	7.2	7.8	0.0	5.6%
<b>Kuintili i indeksit të pasurisë</b>	Ferizaj	11.0	9.4	0.0	7.8%
	Më i varfëri	8.6	12.3	1.6	7.9%
	I dyti	5.0	8.4	0.5	5.0%
	I mesmi	6.9	5.2	0.0	4.8%
	I katërti	4.5	2.8	0.5	3.2%
	Më i pasuri	6.3	7.0	0.0	4.6%
<b>Gjithsej</b>		<b>6.4</b>	<b>7.9</b>	<b>0.6</b>	<b>5.3</b>

Karakteristikat e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në punën e fëmijëve janë disi të ndryshme (tabela 3.3). Së pari, prevalenca më e lartë e punës së fëmijëve mund të gjendet tek fëmijët më të vegjël; 8.2 për qind e fëmijëve të moshës 5-11 vjeç krahasuar me 6.2 për qind të fëmijëve 12-14 vjeç dhe 5.2 për qind të fëmijëve të moshës 15-17 vjeç. Së dyti, djemtë (9.2 përqind) kanë dy herë më shumë gjasa të jenë në punë të fëmijëve sesa vajzat (4.6 përqind) në këto komunitete. Së treti, puna e fëmijëve është gjithashtu më e përhapur në zonat rurale (8.1 përqind) sesa në ato urbane (6 përqind). Së fundi, ndërkohë që përqindjet e punës së fëmijëve janë më të larta edhe për ekonomitë familjare më të varfra në këto komunitete, fëmijët nga kuintili i dytë më i ulët i indeksit të pasurisë shfaqin përqindjen më të lartë të fëmijëve në punën e fëmijëve (8.8 përqind). Prandaj, profili më i mundshëm i fëmijëve që punojnë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë është një djalë i moshës 5 deri në 11 vjeç nga ekonomitë e dyta familjare më të varfra në zonat rurale.

► **Tabela 3.3. Përqindja e fëmijëve në punën e fëmijëve, sipas grupmoshës, gjinisë, vendbanimit, rajonit dhe kuintilit të të ardhurave të ekonomisë familjare, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**

		Grupmosha			Gjithsej fëmijë
		Fëmijët e moshës 5-11 vjeç (%)	Fëmijët e moshës 12-14 vjeç (%)	Fëmijët e moshës 15-17 vjeç (%)	5-17 vjeç (%)
<b>Gjinia</b>	Mashkull	9.6	7.4	10.0	9.2
	Femër	6.6	4.8	0.0	4.6
<b>Vendbanimi</b>	Urban	6.7	6.1	4.4	6.0
	Rural	9.7	6.2	6.0	8.1
<b>Kuintili i indeksit të pasurisë</b>	Më i varfëri	8.7	6.9	4.8	7.5
	I dyti	11.3	7.6	3.9	8.8
	I mesmi	4.8	7.5	6.3	5.8
	I katërti	5.8	1.7	8.6	5.7
	Më i pasuri	9.2	8.0	0.0	6.8
<b>Gjithsej</b>		<b>8.2</b>	<b>6.2</b>	<b>5.2</b>	<b>7.0</b>

Një mënyrë për të parë ndërveprimin midis punës së fëmijëve dhe shkollimit është zberthimi i popullsisë së fëmijëve në katër grupe aktivitetesh që nuk mbivendosen - fëmijët që vetëm punojnë, fëmijët që vetëm ndjekin shkollën, fëmijët që kombinojnë shkollën dhe punën dhe fëmijët që nuk bëjnë asnjërin. Tabelat 3.4 dhe 3.5 paraqesin këtë tregues veçmas për fëmijët e moshës 5-14 dhe 15-17 vjeç. Ato fokusohen në angazhimin e një fëmije në aktivitetet ekonomike në vend të punës së fëmijëve për të përfshirë një grup më të madh fëmijësh që mund të jenë në rrezik nga puna e fëmijëve. Një gjetje kryesore që bie në sy nga të dyja tabelat për fëmijët në Kosovë është se shumica dërrmuese e fëmijëve ndjekin shkollën. Madje shumica e fëmijëve që punojnë kombinojnë shkollën me punën. Ka më pak gjasa që fëmijët vetëm të punojnë (1 për qind për fëmijët e moshës 5-14 vjeç kundrejt 1.8 për qind për ata të moshës 15-17 vjeç) sesa "as nuk ndjekin shkollën as nuk punojnë" (4 për qind për fëmijët 5-14 vjeç kundrejt 6.5 për qind për ata të moshës 15-17 vjeç). Trendet janë të ngjashme për të dy gjinitë, statusin e vendbanimit dhe zonat rajonale.

► Tabela 3.4. Statusi i aktivitetit të fëmijës sipas gjinisë, rajonit dhe vendbanimit, grupmosha 5-14 vjeç, në përgjithësi në Kosovë (përqindje)

		Kategoritë e aktiviteteve ndërsjellshëmrisht përjashtuese				(a)dhe(c)	(b)dhe(c)	(a)dhe(d)	
		(a)	(b)	(c)	(d)	Totali që punojnë (%)	Totali që shkollohen (%)	Totali jashtë shkolliës (%)	
		Që vetëm punojnë (%)	Që vetëm shkollohen (%)	Që punojnë dhe shkollohen (%)	Asnjë aktivitet (%)				
<b>Gjinia</b>	Mashkull	0.7	79.9	14.9	4.5	15.7	94.8	5.2	
	Femër	0.3	91.0	5.6	3.1	5.9	96.6	3.4	
<b>Vendbanimi</b>	Urban	0.7	88.7	5.9	4.8	6.6	94.5	5.5	
	Rural	0.4	82.9	13.6	3.1	14.0	96.5	3.5	
<b>Rajoni</b>	Gjakovë	0.0	84.5	9.2	6.3	9.2	93.7	6.3	
	Gjilan	0.3	90.0	7.9	1.9	8.1	97.8	2.2	
	Mitrovicë	0.2	84.2	12.4	3.3	12.6	96.6	3.4	
	Pejë	0.6	81.5	11.0	6.9	11.6	92.5	7.5	
	Prizren	0.4	87.1	8.9	3.7	9.3	95.9	4.1	
	Prishtinë	1.0	85.4	10.4	3.2	11.4	95.7	4.3	
	Ferizaj	0.3	83.8	12.8	3.1	13.1	96.6	3.4	
	<b>Gjithsej 5-14</b>		<b>0.5</b>	<b>85.3</b>	<b>10.4</b>	<b>3.8</b>	<b>10.9</b>	<b>95.7</b>	<b>4.4</b>

► **Tabela 3.5. Statusi i aktivitetit të fëmijës sipas gjinisë, rajonit dhe vendbanimit, grupmosha 15-17 vjeç, në përgjithësi në Kosovë (përqindje)**

		Kategoritë e aktiviteteve ndërsjellshëmrisht përjashtuese				(a)dhe(c)	(b)dhe(c)	(a)dhe(d)
		(a)	(b)	(c)	(d)	Totali që punojnë (%)	Totali që shkollohen (%)	Totali jashtë shkollës (%)
		Që vetëm punojnë (%)	Që vetëm shkollohen (%)	Që punojnë dhe shkollohen (%)	Asnjë aktivitet (%)			
<b>Gjinia</b>	Mashkull	3.2	59.5	29.6	7.6	32.8	89.2	10.9
	Femër	0.0	86.7	8.1	5.2	8.1	94.8	5.2
<b>Vendbanimi</b>	Urbane	1.8	78.3	12.0	7.8	13.9	90.4	936
	Rurale	1.7	67.6	25.1	5.6	26.8	92.7	7.3
<b>Rajoni</b>	Gjakovë	0.0	60.9	23.2	15.9	23.2	84.1	15.9
	Gjilan	2.2	73.7	24.1	0.0	26.3	97.8	2.2
	Mitrovicë	0.9	78.6	16.8	3.7	17.8	95.4	4.6
	Pejë	3.4	65.6	25.2	5.8	28.6	90.9	9.2
	Prizren	4.6	68.9	17.8	8.7	22.4	86.7	13.4
	Prishtinë	1.1	72.4	18.7	7.8	19.9	91.1	8.9
	Ferizaj	0.6	81.7	17.7	0.0	18.3	99.4	0.6
<b>Gjithsej 15-17</b>		<b>1.8</b>	<b>72.0</b>	<b>19.8</b>	<b>6.5</b>	<b>21.5</b>	<b>91.7</b>	<b>8.3</b>

Situata në këtë drejtim është më shqetësuese për fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (tabela 3.6 dhe 3.7). Pothuajse një në katër fëmijë të moshës 5-14 vjeç dhe tre në pesë fëmijë të moshës 15-17 vjeç nuk vijnë në shkollë. Për më tepër, shumica e fëmijëve jashtë shkollës nuk janë të angazhuar në ndonjë aktivitet pune. Këto gjetje vlejshme sipas moshës, gjinisë dhe vendbanimit, por situata duket veçanërisht alarmante për vajzat ose fëmijët nga zonat rurale në grupmoshën 15-17 vjeç. Vetëm 37.3 për qind e vajzave të moshës 15-17 vjeç ndjekin shkollën, ndërsa 60.8 për qind nuk ndjekin as shkollën dhe as punojnë. Po kështu, në zonat rurale, vetëm 35.1 për qind e fëmijëve të moshës 15-17 vjeç ndjekin shkollën, ndërsa 54 për qind nuk ndjekin as shkollën dhe as punojnë.



► **Tabela 3.6. Statusi i aktivitetit të fëmijës sipas gjinisë, rajonit dhe vendbanimit, grupmosha 5-14 vjeç, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (përqindje)**

		Kategoritë e aktiviteteve ndërsjellshëmrisht përjashtuese				(a)dhe(c)	(b)dhe(c)	(a)dhe(d)
		(a)	(b)	(c)	(d)	Totali që punojnë (%)	Totali që shkollohen (%)	Totali jashtë shkollës (%)
		Që vetëm punojnë (%)	Që vetëm shkollohen (%)	Që punojnë dhe shkollohen (%)	Asnjë aktivitet (%)			
<b>Gjinia</b>	Mashkull	1.5	69.6	8.2	20.8	9.7	77.7	22.3
	Femër	2.0	70.7	4.7	22.5	6.8	75.5	24.6
<b>Vendbanimi</b>	Urbane	1.8	66.4	5.4	26.4	7.2	71.8	28.2
	Rurale	1.7	73.8	7.7	16.8	9.4	81.5	18.5
<b>Gjithsej 5-14</b>		<b>1.8</b>	<b>70.1</b>	<b>6.5</b>	<b>21.6</b>	<b>8.3</b>	<b>76.7</b>	<b>23.4</b>

► **Tabela 3.7. Statusi i aktivitetit të fëmijës sipas gjinisë, rajonit dhe vendbanimit, grupmosha 5-17 vjeç, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (përqindje)**

		Kategoritë e aktiviteteve ndërsjellshëmrisht përjashtuese				(a)&(c)	(b)&(c)	(a)&(d)
		(a)	(b)	(c)	(d)	Totali që punojnë(%)	Totali që shkollohen (%)	Totali jashtë shkollës (%)
		Që vetëm punojnë (%)	Që vetëm shkollohen (%)	Që punojnë dhe shkollohen (%)	Asnjë aktivitet (%)			
<b>Gjinia</b>	Mashkull	20.0	40.3	7.8	32.0	27.7	48.1	51.9
	Femër	1.9	35.1	2.2	60.8	4.1	37.3	62.7
<b>Vendbanimi</b>	Urbane	11.6	42.5	7.2	38.7	18.8	49.7	50.3
	Rurale	10.9	32.4	2.7	54.0	13.7	35.1	64.9
<b>Gjithsej 15-17</b>		<b>11.3</b>	<b>37.8</b>	<b>5.1</b>	<b>45.8</b>	<b>16.4</b>	<b>42.9</b>	<b>57.1</b>

Kështu, në shikim të parë, angazhimi në aktivitete ekonomike nuk duket se i pengon fëmijët në përgjithësi në Kosovë që të investojnë në arsimimin e tyre, për sa i përket vijueshmërisë në shkollë. Me fjalë të tjera, shkollimi është i kombinuar me punën për shumicën e fëmijëve. Megjithatë, për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, "të mosbërit asgjë" e fëmijëve është shqetësuese; një pjesë e madhe e tyre nuk ndjekin as shkollën dhe as punën. Nënseksionet e mëposhtme na lejojnë të shqyrtojmë më tej karakteristikat dhe çështjet e ndërlidhura në aspektin e shëndetit dhe arsimit për të kuptuar më mirë shtrirjen e problemit të punës së fëmijëve dhe implikimet e saj në Kosovë.


## 3.2. Faktorët e ekonomisë familjare dhe komunitetit që lidhen me punën e fëmijëve

Ky nënseksion fokusohet në tiparet kryesore të ekonomive familjare dhe komunitetit që zakonisht lidhen me punën e fëmijëve. Ai mund të shërbejë si një sfond për një diskutim më të gjerë se pse fëmijët përfshihen në aktivitete fitimprurëse dhe çfarë mund të bëhet për të trajtuar format më të rënda të punës së fëmijëve. Për shembull, për të arritur një të kuptuar fillestar të faktorëve që do të synohen për përgjigjet e politikave, domethënë faktorëve që shkaktojnë punën e fëmijëve, mund të jetë e dobishme të lidhet frekuenca e punës së fëmijëve me karakteristikat e ekonomive familjare të fëmijëve dhe zonave në të cilat ata jetojnë. Megjithatë, nxjerrja e konkluzioneve të politikave bazuar vetëm në korrelacione duhet të bëhet me kujdes sepse korrelacioni nuk nënkupton shkakësi.

Puna e fëmijëve është përgjithësisht më e përhapur në mesin e fëmijëve me të ardhura të ulëta dhe/ose të varfër. Ky zbulim nxjerr në pah se ka të ngjarë që ekonomitë familjare në situata të vështira socio-ekonomike i drejtohen punës së fëmijëve për të mbuluar nevojat e tyre themelore. Megjithatë, marrëdhënia midis punës së fëmijëve dhe varfërisë mund të shkojë edhe në drejtimin e kundërt. Fëmijëve të cilëve iu mohohet arsimimi ose pengohet nga puna e fëmijëve u mungojnë aftësitë e nevojshme për një punë të përshtatshme kur të arrijnë pjekurinë, duke rritur gjasat e tyre për të jetuar në varfëri. Figurat 3.1 dhe 3.2 tregojnë normat e punës së fëmijëve në total dhe sipas gjinisë për ekonomitë familjare me kuintile të ndryshme të indeksit të pasurisë dhe nivele të privimit material.


Figura 3.1 tregon se pjesa e fëmijëve në punën e fëmijëve në Kosovë përgjithësisht zvogëlohet sa më e lartë qëndron ekonomia familjare në shpërndarjen e pasurisë; fëmijët në ekonomitë familjare në kuintilin më të ulët të indeksit të pasurisë kanë më shumë gjasa të jenë në punën e fëmijëve se sa fëmijët e tjerë. Ajo tregon gjithashtu se djemtë kanë shumë më shumë gjasa sesa vajzat të jenë në punën e fëmijëve në çdo kuintil të indeksit të pasurisë, përveç atij të mesëm dhe të katërt, ku vlen e kundërta. Megjithatë, gjasat e punës së fëmijëve nuk ndryshojnë në thelb midis fëmijëve nga ekonomitë familjare të niveleve të ndryshme të privimit material. Megjithatë, gjetjet sipas gjinisë ndryshojnë disi - ekziston një korrelacion negativ midis privimit material të ekonomisë familjare dhe punës së fëmijëve për vajzat, ndërsa e kundërta është e vërtetë për djemtë.

► Figura 3.1. Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç në punë të fëmijëve, sipas kuintilit të pasurisë të ekonomisë familjare, privimeve materiale të ekonomisë familjare dhe gjinisë, në përgjithësi në Kosovë



Marrëdhëniet ndërmjet pasurisë së ekonomisë familjare, privimit material dhe punës së fëmijëve nuk janë të drejtpërdrejta për fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Për shembull, figura 3.2 tregon se djemtë nga ekonomitë familjare më të varfra kanë më shumë gjasa të jenë në punën e fëmijëve, por ky nuk është rasti për vajzat. Marrëdhënia negative ndërmjet privimit material të ekonomisë familjare dhe vajzave në punën e fëmijëve e konstatuar për Kosovën në përgjithësi vlen edhe për vajzat rome, ashkali dhe egjiptiane. Megjithatë, djemtë nga ekonomitë familjare pa privime materiale kanë më shumë gjasa të jenë në punën e fëmijëve sesa ata me të paktën një privim material. Një shpjegim mund të jetë se këta djem që punojnë kontribuojnë në mirëqenien materiale të familjes, prandaj edhe kemi korrelacionin pozitiv midis të dyjave.


► **Figura 3.2. Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç në punë të fëmijëve, sipas kuintilit të pasurisë së ekonomisë familjare, privimeve materiale të ekonomisë familjare dhe gjinisë, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**




Një tjetër karakteristikë e rëndësishme e ekonomisë familjare që lidhet me gjasat që fëmijët të përfshihen në punën e fëmijëve është formimi arsimor i kryefamiljarit. Nëse fëmija vjen nga një ekonomi familjare me një kryefamiljar me arsim të lartë, ka më pak gjasa që ai të ekspozohet ndaj punës së fëmijëve. Supozimi themelor është se të rriturit në atë ekonomi familjare janë më mirë të pajisur për të ndihmuar fëmijët e tyre për të shfrytëzuar maksimalisht potencialin e tyre të rritjes së të ardhurave, sepse ata janë më të vetëdijshëm për përfitimet e arsimit dhe/ose janë në një pozicion më të mirë për ta bërë këtë.

Figura 3.3 tregon se kjo gjetje është e vërtetë për fëmijët e Kosovës në përgjithësi: sa më i arsimuar të jetë kryefamiljari, aq më e ulët është përqindja e fëmijëve në punën e fëmijëve për atë grup të ekonomive familjare. Anasjelltas, fëmijët në ekonomitë familjare ku kryefamiljari nuk ka pasur arsim kanë më shumë gjasa të jenë në punën e fëmijëve. Për më tepër, megjithëse vajzat kanë më pak gjasa të jenë në punën e fëmijëve sesa djemtë, korrelacioni negativ midis arsimimit të kryefamiljarit dhe punës së fëmijëve vlen për të dy gjinitë. Kjo marrëdhënie nuk është aq e qartë për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë, siç tregon figura 3.4. Përqindja më e lartë e punës së fëmijëve mund të gjendet në ekonomitë familjare ku nuk ka informacion mbi arsimin e kryefamiljarit. Megjithatë, ngjashëm me raportin me pasurinë e ekonomisë familjare, vajzat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë më të rrezikuara nga puna e fëmijëve, sa më pak i arsimuar është kryefamiljari i tyre.


► Figura 3.3. Puna e fëmijëve dhe niveli arsimor i kryefamiljarit, në përgjithësi në Kosovë



► Figura 3.4. Puna e fëmijëve dhe niveli arsimor i kryefamiljarit, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian



► Figura 3.5. Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç në punën e fëmijëve, sipas nivelit arsimor dhe gjinisë së kryefamiljarit, në përgjithësi në Kosovë




Ndërsa niveli arsimor i kryefamiljarit përfaqësontribute të shumta socio-ekonomike të prapavijës familjare, niveli arsimor i prindërve mund të ofrojë një pamje edhe më të thellë të marrëdhënies midis arsimit dhe punës së fëmijëve. Figura 3.5 tregon prevalencën e punës së fëmijëve sipas arsimimit të nënave dhe baballarëve të fëmijëve. Ngjashëm me gjetjet për arsimimin e kryefamiljarit, arsimit i prindërve është gjithashtu i lidhur negativisht me prevalencën e punës së fëmijëve. Kjo marrëdhënie është disi më e fortë për nivelin arsimor të nënës. Fëmijët që nuk jetojnë me baballarët biologjikë kanë për afërsisht po aq gjasa të jenë në punën e fëmijëve sa ata me baballarë që kanë më e shumta arsim fillor. Këto trendë janë të ngjashme si për djemtë ashtu edhe për vajzat.

Ashtu si rezultatet e bazuara në arsimimin e kryefamiljarëve, nuk ka një lidhje aq të qartë ndërmjet punës së fëmijëve dhe arsimimit të prindërve të tyre për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë. Megjithatë, figura 3.6 tregon se përqindja më e vogël e fëmijëve në punën e fëmijëve mund të gjendet tek ata që e kanë nënën e arsimuar të paktën në nivelin e mesëm të lartë. Për më tepër, vajzat kanë më pak gjasa të jenë në punën e fëmijëve sa më i arsimuar që është babai i tyre, ndërsa e kundërta vlen për djemtë.

Përveç pasqyrimin të vlerave për arsimin, këto gjetje përfaqësojnë gjithashtu mjetet financiare dhe sfondin e përgjithshëm socio-ekonomik të ekonomive familjare dhe prindërve. Sa më pak e pasur të jetë ekonomia familjare, aq më të rrezikuar janë fëmijët nga puna e fëmijëve në përgjithësi në Kosovë. Kjo lidhje është e fortë edhe për vajzat romë, ashkali dhe egjiptiane, ndërsa e kundërta shpesh është e vërtetë për djemtë. Një shpjegim mund të jetë se këta djem romë, ashkali dhe egjiptianë në punë të fëmijëve kontribuojnë në pasurinë e ekonomisë familjare; rrjedhimisht kemi korrelacionin pozitiv midis arsimit dhe punës së fëmijëve.

► **Figura 3.6. Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç në punën e fëmijëve, sipas nivelit arsimor dhe gjinisë së kryefamiljarit, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**



### 3.3. Intensiteti kohor i punës së fëmijëve

Ky nënseksion fokusohet në kohën e kaluar të fëmijëve në punën e fëmijëve, pasi kjo mund të ketë pasojat për shëndetin dhe edukimin e tyre. Puna për një periudhë të gjatë jo vetëm që mund t'i lodhë fëmijët, por edhe t'i ekspozojë më tej ndaj rreziqeve në vendin e punës. Si rezultat, fëmijët mund të humbin kohën e paraparë për mësim dhe aktivitete të tjera miqësore për fëmijët. Kjo pjesë fokusohet vetëm në orët e vetëraportuara në aktivitetin ekonomik. Orët në punët e shtëpisë dhe orët totale të punës së fëmijëve janë dhënë në nënseksionin 3.6.

Tabela 3.8 jep orët mesatare të aktivitetit fitimprurës për fëmijët në punën e fëmijëve sipas moshës, gjinisë dhe vendbanimit. Duhet theksuar se qelizat e zbrazëta të tabelës për vajzat 12-17 vjeç janë për shkak të mungesës së vëzhgimeve të punës së fëmijëve për atë kategori. Fëmijët e përfshirë në punën e fëmijëve shpenzojnë 10.3 orë pune në javë në përgjithësi në Kosovë. Ata të moshës 15-17 vjeç punojnë dukshëm më shumë se fëmijët më të vegjël: 58.8 kundrejt 8.4 orë në javë. Djemtë punojnë mesatarisht më shumë orë se vajzat; 12.2 krahasuar me 4.7 orë në javë. Fëmijët e përfshirë në punën e fëmijëve në zonat rurale punojnë pak më shumë orë se ata në zonat urbane: 10.6 kundrejt 9.4 orë në javë.

► **Tabela 3.8. Intensiteti kohor i punës së fëmijëve: Orari mesatar javor i punës, sipas moshës, vendbanimit dhe gjinisë, në përgjithësi në Kosovë**

		Orari i punës sipas grupmoshave				
		5-11 vjeç	12-14 vjeç	15-17 vjeç	5-14 vjeç	5-17 vjeç
<b>Gjinia</b>	Mashkull	6.0	17.4	58.8	9.8	12.2
	Femër	4.7			4.7	4.7
<b>Vendbanimi</b>	Urbane	6.9	18.8	56.0	8.2	9.4
	Rurale	4.9	17.2	59.4	8.5	10.6
<b>Gjinia dhe vendbanimi</b>	Mashkull, urban	7.6	18.8	56.0	9.0	10.2
	Mashkull, rural	4.8	17.2	59.4	10.2	13.1
	Femër, urban	1.4			1.4	1.4
	Femër, rural	5.0			5.0	5.0
<b>Gjinia dhe vendbanimi</b>		<b>5.5</b>	<b>17.4</b>	<b>58.8</b>	<b>8.4</b>	<b>10.3</b>

Tabela 3.9 tregon se fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian punojnë pothuajse dy herë më shumë se fëmijët në punën e fëmijëve në përgjithësi në Kosovë: 18.6 orë në javë për dallim nga mesatarja kombëtare prej 10.3 orë. Edhe në këtë nëngrup fëmijësh, ata të moshës 15-17 vjeç punojnë dukshëm më shumë se fëmijët më të vegjël: 61.2 kundrejt 7.6 orësh në javë. Ky boshllëk i rëndësishëm shkaktohet kryesisht nga orët e punës së djemve. Në këto komunitete, ndryshimi në intensitetin kohor të punës së fëmijëve në zonat rurale kundrejt atyre urbane është i papërfillshëm.

► **Tabela 3.9. Intensiteti kohor i punës së fëmijëve: Orari mesatar javor i punës, sipas moshës, vendbanimit dhe gjinisë, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**



		Orari i punës sipas grupmoshave				
		5-11 years	12-14 years	15-17 years	5-14 years	5-17 years
<b>Gjinia</b>	Mashkull	5.9	24.5	61.2	8.9	23.3
	Femër	5.1			5.1	5.1
<b>Vendbanimi</b>	Urbane	6.4	18.0	58.6	6.7	19.1
	Rurale	5.0	25.3	63.4	8.2	18.2
<b>Gjinia dhe vendbanimi</b>	Mashkull, urban	9.1	18.0	58.6	9.8	31.9
	Mashkull, rural	4.9	25.3	63.4	8.6	20.0
	Femër, urban	4.8			4.8	4.8
	Femër, rural	5.8			5.8	5.8
<b>Gjithsej</b>		<b>5.6</b>	<b>24.5</b>	<b>61.2</b>	<b>7.6</b>	<b>18.6</b>

### 3.4. Puna e fëmijëve dhe shkollimi

Një nga faktorët më të rëndësishëm në përcaktimin e efekteve afatgjata të punës së fëmijëve është shkalla në të cilën ajo ndërhyr në edukimin e fëmijëve. Fëmijët e përfshirë në punën e fëmijëve zakonisht ose janë të privuar plotësisht nga shkollimi ose shpenzojnë shumë më pak kohë në aktivitete edukative. Kështu ata do të ishin në disavantazh për sa i përket aftësisë së tyre për të fituar arsimin dhe aftësitë e kërkuara për një punësim më fitimprurës kur të arrijnë moshën madhore. Prandaj, ky nënseksion shqyrton marrëdhëniet midis punës së fëmijëve dhe arsimit, duke u fokusuar veçanërisht në mënyrën se si puna e fëmijëve mund të ndikojë në aftësinë e fëmijëve për të ndjekur shkollën. Qëndrimi dhe përparimi në sistemet arsimore janë gjithashtu aspekte thelbësore të suksesit të fëmijëve në rrugën e tyre arsimore. Për më tepër, ndarja sipas moshës dhe gjinisë mund të zbulojë grupe veçanërisht të cenueshme. Megjithatë, të dhënat e anketës nuk kanë informacion thelbësor për të ndërtuar këta tregues dhe disagregimi është i kufizuar për shkak të një numri të ulët vëzhgimesh.

Shifrat e mëposhtme paraqesin shkallën e të qenit jashtë shkollës të fëmijëve të përfshirë në punën e fëmijëve, veçanërisht, disavantazhin e tyre relativ në këtë drejtim kundrejt fëmijëve që nuk janë në punën e fëmijëve për dy grupmosha të gjera: 6-14 (shkolla fillore dhe e mesme) dhe 15-17 (shkolla e mesme). Figura 3.7 tregon se shkalla e mosvijimit është më e lartë për fëmijët në punën e fëmijëve në përgjithësi në Kosovë sesa për bashkëmoshatarët e tyre që nuk janë të përfshirë në punën e fëmijëve. Rreth 8.7 për qind e fëmijëve të moshës 6-14 vjeç të angazhuar në punën e fëmijëve nuk ndjekin shkollën, në krahasim me vetëm 1.7 për qind të fëmijëve të së njëjtës grupmoshë, që nuk janë të përfshirë në punën e fëmijëve. Hendeku është edhe më i rëndësishëm për fëmijët më të rritur: 33.4 për qind e fëmijëve të moshës 15-17 vjeç në punën e fëmijëve janë jashtë shkollës krahasuar me 8.1 për qind për ata fëmijë që nuk janë në punën e fëmijëve.

Figura 3.8 fokusohet te fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë. Trendi është i njëjtë për fëmijët e këtyre komuniteteve, por duhet theksuar se shkalla e tyre e mosvijimit është jashtëzakonisht e lartë. Pothuajse 9 në 10 fëmijë të përfshirë në punën e fëmijëve të moshës 15-17 vjeç nuk e ndjekin shkollën. Megjithatë, shkalla e mosvijimit bie në gjashtë në dhjetë fëmijë për ata që nuk angazhohen në punën e fëmijëve. Situata është pak më pak e rëndë për fëmijët e moshës 6-14 vjeç; rreth tre në dhjetë prej tyre që angazhohen në punën e fëmijëve janë jashtë shkollës kundrejt dy në dhjetë për ata që nuk janë të përfshirë në punën e fëmijëve.

► **Figura 3.7. Shkalla e fëmijëve që janë jashtë shkollës dhe puna e fëmijëve, fëmijët e moshës 6-17 vjeç, në përgjithësi në Kosovë**► **Figura 3.8. Shkalla e fëmijëve që janë jashtë shkollës dhe puna e fëmijëve, fëmijët e moshës 6-17 vjeç, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**

Në seksionin 3.1, ne pamë se fëmijët në Kosovë zakonisht kombinojnë punën me shkollimin. Megjithatë, ky seksion ofron një pamje të ndryshme për ata që janë në situatat më të këqija. Fëmijët e përfshirë në punën e fëmijëve kanë më shumë gjasa të mungojnë plotësisht në sistemin arsimor sesa ata që nuk angazhohen në punën e fëmijëve. Për më tepër, fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë veçanërisht të cenueshëm në këtë aspekt. Kështu, ka ende hapësirë të konsiderueshme për përparim në të siguruarit që këta fëmijë të qëndrojnë në shkollë.

### 3.5. Ekspozimi ndaj rreziqeve të shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës


Ky nënseksion fokusohet në rreziqet e shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës që i nënshtrohen fëmijët. Aspektet e shëndetit dhe sigurisë të punës së fëmijëve janë thelbësore për legjislacionin ndërkombëtar të punës së fëmijëve, i cili përcakton standardet për fushat, vendet e punës dhe kushtet e punës që duhet të mbulohen në përkufizimet kombëtare të punës së rrezikshme. Përgjigjet e politikave duhet pra t'u japin përparësi këtyre fushave kur luftohet puna e fëmijëve. Ndonëse anketa MICS 2019-20 në Kosovë nuk mblodhi informacion mbi profesionet ose industritë të aktiviteteve ekonomike të fëmijëve, ajo kishte në fakt një seksion mbi ekspozimin e fëmijëve ndaj disa kushteve të rrezikshme në vendin e tyre të punës. Ky informacion nuk lejon konstruktimin e treguesve të punës së rrezikshme siç përcaktohet nga ILO, por megjithatë shpalos informacion mbi situatat me të cilat përballen fëmijët që punojnë edhe nëse nuk klasifikohen si "në punën e fëmijëve" sipas treguesit OZHQ 8.7.1.

Figura 3.9 tregon se pak fëmijë janë të ekspozuar ndaj kushteve të rrezikshme në vendin e punës. Rreziku më i zakonshëm në vendin e punës është ekspozimi ndaj temperaturave ekstreme ose lagështisë, pluhurit, tymrave ose gazit; rreth 2.7 për qind e fëmijëve janë të ekspozuar ndaj të paktën njërit prej tyre. Edhe pse ekspozimi mbetet i ulët, djemtë janë prapëseprapë më të ekspozuar ndaj rreziqeve të shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës sesa vajzat. Figura 3.10 tregon se kushtet e




rrezikshme janë dy herë më të përhapura për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë. Përveç kësaj, hendeku ndërmjet djemve dhe vajzave në këto komunitete është edhe më i madh se sa për fëmijët në përgjithësi në Kosovë.

► **Figura 3.9. Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç të ekspozuar ndaj rreziqeve të shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës, sipas llojit të rrezikut dhe gjinisë, në përgjithësi në Kosovë**




► **Figura 3.10. Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç të ekspozuar ndaj rreziqeve të shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës, sipas llojit të rrezikut dhe gjinisë, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**




Ndonëse duket se jo shumë fëmijë përballen me kushte të rrezikshme në vendin e tyre të punës, situata ndryshon ndjeshëm kur krahasohen fëmijët në punën e fëmijëve me ata jo në punën e fëmijëve. Figura 3.11 tregon se për çdo lloj kushtesh të rrezikshme, fëmijët në punën e fëmijëve kanë dukshëm më shumë gjasa të jenë përballur me atë rrezik në vendin e tyre të punës sesa ata që nuk janë të angazhuar në punën e fëmijëve. Për shembull, 18.2 për qind e fëmijëve në punën e fëmijëve janë ekspozuar ndaj temperaturave ekstreme ose lagështisë në vendin e tyre të punës krahasuar me vetëm 1.8 për qind të fëmijëve të tjerë që punojnë. Për më tepër, figura 3.12 tregon se nivelet e ekspozimit ndaj kushteve të rrezikshme janë edhe më shqetësuese për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë që punojnë. Përafërsisht një në tre fëmijë në punën e fëmijëve të këtyre komuniteteve janë të ekspozuar ndaj pluhurit, tymrave ose gazit në vendin e tyre të punës. Kjo shifër është vetëm 1.8 për qind për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë që nuk janë në punën e fëmijëve. Këto gjetje theksojnë probleme të mëtejshme kritike që shoqërojnë fëmijët në këto rrethana të pasigurta, të cilave përgjigjet e politikave duhet t’u kushtojnë vëmendje të veçantë.

► Figura 3.11. Kushtet e rrezikshme dhe puna e fëmijëve: Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç, në përgjithësi në Kosovë



► Figura 3.12. Kushtet e rrezikshme dhe puna e fëmijëve: Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian




### 3.6. Punët e shtëpisë

Ky nënseksion i fundit i analizës përshkruese fokusohet në një pjesë të rëndësishme të punës së fëmijëve siç përcaktohet në këtë raport: përfshirja e fëmijëve në punët e shtëpisë. Kujdesi për anëtarët e familjes, pastrimi dhe riparimet e vogla të shtëpisë, përgatitja dhe servirja e vakteve, larja dhe hekurrosja e rrobave dhe shoqërimi i anëtarëve të familjes për në punë dhe shkollë dhe në kthimin nga puna dhe shkolla janë të gjitha shembuj të detyrave shtëpiake të kryera pa pagesë. Për më tepër, ofrohet edhe zbërthimi sipas gjinisë, pasi është jetike të shpaloset dimensiononi gjinor në barrën e këtyre detyrave shtëpiake.

Pasqyra e përqindjes së fëmijëve që kryejnë punët e shtëpisë raportohet ndarazi për fëmijët që shpenzojnë të paktën një orë dhe ata që shpenzojnë më shumë se 20 orë duke kryer këto detyra në javën e kaluar si periudhë referuese. Hulumentimi sugjeron se pragu i 21 orëve javore është pika ku punët e shtëpisë fillojnë të ndikojnë negativisht në aftësinë e fëmijëve për të ndjekur dhe për të përfituar nga shkolla. Megjithatë, duhet theksuar se nuk janë vendosur norma ligjore apo statistikore të dakorduara se sa kohë e shpenzuar për kryerjen e punëve është e tepruar.


Figura 3.13 tregon se përfshirja në punët e shtëpisë rritet me moshën e fëmijës. Rreth 60 fëmijë të moshës 5-14 vjeç dhe 80 për qind e atyre të moshës 15-17 vjeç kryejnë punët e shtëpisë për të paktën një orë në javë. Më pak fëmijë kryejnë punët e shtëpisë për më shumë se 20 orë në javë. Përafërsisht 40 dhe 50 për qind e fëmijëve të moshës 5-14, përkatësisht 15-17 vjeç, kalojnë prapen dhe specifikuar të orëve javore. Një tjetër gjetje kryesore që del nga figura 3.13 është se vajzat kanë shumë më shumë gjasa të përfshihen në punët e shtëpisë në çdo moshë dhe intensitet të përfshirjes sesa djemtë. Hendeku është më i dukshëm për vajzat e moshës 15-17 vjeç dhe zvogëlohet pak kur shikohet përfshirja në punët e shtëpisë për të paktën 21 orë në javë.

► Figura 3.13. Përqindja e fëmijëve që kryejnë punët e shtëpisë, sipas pragut të orëve, moshës dhe gjinisë, në përgjithësi në Kosovë




Rezultatet nuk janë shumë të ndryshme kur merren parasysh vetëm fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Fëmijët më të rritur gjithashtu kanë më shumë gjasa të kryejnë detyra shtëpiake në këtë nëngrup. Figura 3.14 tregon se shkalla e kryerjes së punëve për të paktën një orë në javë është e njëjtë për këto komunitete me normën e përgjithshme në Kosovë. Siç pritej, kjo normë bie sapo të rritet pragu në 21 orë në javë. Ngjashëm me gjetjet e përgjithshme për Kosovën, vajzat kanë më shumë gjasa të kryejnë detyra sesa djemtë në pothuajse çdo moshë dhe intensitet kohor. Përrjashtim bëjnë fëmijët më të vegjël -- një pjesë e barabartë e djemve dhe vajzave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të moshës 5-14 janë të përfshirë në punët e shtëpisë për më shumë se 20 orë në javë.

► **Figura 3.14. Përqindja e fëmijëve që kryejnë punët e shtëpisë, sipas pragut të orëve, moshës dhe gjinisë, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**




Ndërsa shumica e fëmijëve kryejnë të paktën disa detyra shtëpiake për të paktën një orë në javë, vajzat përbalen mesatarisht me një barrë më të lartë se djemtë në këtë drejtim. Është gjithashtu thelbësore të kuptohet se çfarë lloj detyrash kryejnë këta fëmijë, pasi kjo mund të zbulojë çdo ndarje gjinore në punët e shtëpisë. Figura 3.15 dhe 3.16 tregojnë se larja e enëve ose pastrimi i shtëpisë janë detyrat më të zakonshme për vajzat në përgjithësi në Kosovë dhe veçanërisht për ato të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Këto detyra janë kanë një dimension të dukshëm gjinor; rreth një në dy vajza krahasuar me afërsisht një në dhjetë djem kanë kryer larje dhe pastrim të shtëpisë. Figura 3.15 dhe 3.16 tregojnë gjithashtu se blerjet janë detyra me dallimet më të pakta gjinore: një pjesë pothuajse e barabartë e djemve dhe vajzave janë të përfshirë në këtë punë shtëpiake. Detyrat më pak të shpeshta shtëpiake janë shkuarja për të marrë dru ose ujë për përdorim shtëpiak, si për vajzat ashtu edhe për djemtë në përgjithësi në Kosovë dhe në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

► Figura 3.15. Përqindja e fëmijëve të moshës 5-14 vjeç që kryejnë punët e shtëpisë për të paktën 21 orë në javë, sipas llojit të punës dhe gjinisë, në përgjithësi në Kosovë



■ Meshkuj  
■ Femra

► Figura 3.16. Përqindja e fëmijëve të moshës 5-14 vjeç që kryejnë punët e shtëpisë për të paktën 21 orë në javë, sipas llojit të punës dhe gjinisë, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian




■ Meshkuj  
■ Femra


Në fund, ky nënseksion i hedh një vështrim orëve të shpenzuara në punë dhe punët e shtëpisë për fëmijët në punën e fëmijëve për të ofruar një pamje më të plotë të ngarkesës totale të punës të fëmijëve në punën e fëmijëve. Fokusi është te fëmijët e moshës 5-14 vjeç për shkak të përkufizimit të zgjedhur nga ky raport për punën e fëmijëve. Përfshirja në punët e shtëpisë përtej një kufiri të caktuar është relevante vetëm për ata të moshës 5-14 vjeç. Figura 3.17 tregon se fëmijët e kësaj grupmoshe të përfshirë në punën e fëmijëve shpenzojnë mesatarisht 19 orë në javë duke punuar në aktivitete ekonomike dhe punët e shtëpisë. Vajzat shpenzojnë më shumë kohë sesa djemtë, 21 orë krahasuar me 14 orë në javë. Hendeku më i konsiderueshëm gjinor në orët e punës vërehet te 8-vjeçarët. Ngjashëm me gjetjet e mëparshme ku vajzat kanë më shumë gjasa të përfshihen në punët e shtëpisë sesa djemtë, ato gjithashtu shpenzojnë mesatarisht më shumë orë se djemtë në këto aktivitete.

Figura 3.18 paraqet rezultatet për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Fëmijët e këtij grupi shpenzojnë 14 orë në javë në punën e fëmijëve dhe punët e shtëpisë. Nuk ka asnjë ndryshim të madh në orët e punës midis vajzave dhe djemve. Përrjashtim bëjnë fëmijët e moshës 6 vjeç, ku vajzat punojnë dukshëm më gjatë se djemtë. Nuk ka vëzhgime të fëmijëve të përfshirë në punën e fëmijëve të moshës 5 dhe 7 vjeç. Ndërsa vajzat nga këto komunitete kishin më shumë gjasa të përfshiheshin në punët e shtëpisë në çdo moshë sesa djemtë, nuk është e evidente se të parat punojnë më shumë orë në çdo moshë në krahasim me të fundit.

► **Figura 3.17. Koha totale e shpenzuar nga fëmijët e përfshirë në punën e fëmijëve të moshës 5-14 vjeç në punën e fëmijëve dhe punët e shtëpisë, orët mesatare javore të punës, sipas moshës dhe gjinisë, në përgjithësi në Kosovë**



► Figura 3.18. Koha totale e shpenzuar nga fëmijët e përfshirë në punën e fëmijëve të moshës 5-14 vjeç në punën e fëmijëve dhe punët e shtëpisë, orët mesatare javore të punës, sipas moshës dhe gjinisë, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian





## ► 4. Përcaktuesit e punës së fëmijëve: Analiza e regresionit

---

Pas pasqyrës së prevalencës së punës së fëmijëve dhe një vlerësimi të korrelacionit të saj me karakteristikat kryesore të lidhura, ky seksion thellohet tutje në përcaktimin e përcaktuesve të saj. Analiza e regresionit mund të japë vlerësime më të sakta statistikisht të marrëdhënies midis punës së fëmijëve dhe një tipari të veçantë të sfondit të individit, ekonomisë familjare ose komunitetit, duke mbajtur konstante efektet e variablave të tjerë të lidhura. Vlerësimet që rezultojnë janë jetike pasi na mundësojnë të bëjmë sugjerime për qëllime politikash me siguri më të madhe statistikore, duke ngushtuar grupet e synuara për programet e mundshme.

Modeli ekonometrik i zgjedhur për këtë seksion është probit. Puna e fëmijëve është variabla e varur dhe një sërë faktorësh individualë, shtëpiak dhe shoqërorë përdoren si variabla të pavarura<sup>3</sup>. Përzgjedhja e variablave të pavarura bazohet në faktorë kyç që rezultojnë nga modelet e vendimmarrjes së ekonomisë familjare në literaturë dhe gjetjet e forta empirike mbi punën e fëmijëve në përgjithësi. Tabelat e statistikave përmbledhëse për variablat e përdorur janë dhënë në Shtojcën, tabelat A.4 dhe A.5.

Për shembull, ne jemi të vetëdijshëm se, në shumë situata, niveli arsimor i kryefamiljarit ka një korrelacion të konsiderueshëm negativ me punën e fëmijëve. Një qëndrim është se prindërit me nivele më të larta arsimore janë më të vetëdijshëm për përfitimet e arsimit dhe/ose janë në pozitë më të mirë për të ndihmuar fëmijët e tyre në maksimizimin e potencialit të tyre të të ardhurave përmes shkollës. Megjithatë, një ndikim i fshehur i të ardhurave mund të jetë gjithashtu përgjegjës për këtë lidhje. Me fjalë të tjera, kryefamiljarët me nivele më të larta arsimore kanë më shumë gjasa të kenë profesione që paguhen mirë dhe marrëdhënia e kundërt ndërmjet arsimimit në familje dhe punës së fëmijëve mund të jetë, në realitet, e nxitur nga të ardhurat e familjes dhe jo nga arsimit i kryefamiljarit në vetvete.

Në mënyrë të ngjashme, edhe pse sugjeruese, lidhja shpesh e lartë midis të ardhurave dhe punës së fëmijëve nuk mund të interpretohet si provë se puna e fëmijëve është rezultat vetëm i varfërisë. Familjet me të ardhura të ulëta shpesh kanë karakteristika shtesë të cilat mund të ndikojnë gjithashtu mbi atë nëse fëmijët janë të angazhuar apo jo në punën e fëmijëve. Familjet e varfra në aspektin e të ardhurave, për shembull, ndoshta janë të ndryshme nga fqinjët e tyre jo të varfër për sa i përket qasjes së tyre në shërbimet thelbësore, nivelin e arsimit, statusin e punës dhe statusin e pronësisë së tokës, të cilat të gjitha mund të ndikojnë në gjykimet e tyre rreth punës së fëmijëve. Prandaj, ndikimi i të ardhurave duhet të çmbështillet (ndahet) nga shumëllojshmëria e karakteristikave të tjera shtëpiake që shoqërojnë varfërinë ekonomike për të treguar një lidhje shkakësore midis punës së fëmijëve dhe të ardhurave. Së fundi, duhet të theksohet se ndërsa analiza e regresionit bën një punë të mirë në kontrollimin e efekteve të ndryshme të ndërlidhura, ajo nuk heq qafe tërësisht të gjitha burimet e endogjenitetit. Kështu, interpretimi i vlerësimeve si shkakësore kërkon teknika më komplekse dhe rigoroze ekonometrike.

Tabela 4.1 ofron rezultatet nga regresioni probit i punës së fëmijëve mbi karakteristikat kryesore individuale dhe të ekonomisë familjare për 5,322 fëmijë në Kosovë. Kolona e parë jep efektin marginal të llogaritur të secilës variabël të pavarur në probabilitetin që fëmija të jetë në punën e fëmijëve. Me fjalë të tjera, është ndryshimi mesatar në probabilitetin e punës së fëmijëve kur një variabël i caktuar i pavarur

<sup>3</sup> Variablat e pavarura të shqyrtuara në këtë seksion janë: mosha e fëmijës, gjinia, përkatësia etnike, nëse ndjek shkollën, nëse janë jetimë, nëse kujdestari i tyre ka vështirësi funksionale, statusi i vendbanimit të familjes, madhësia e familjes, nëse prindi biologjik jeton në familje, nëse ekonomia familjare ka qasje në ujë, nëse kryefamiljari ka arsim të lartë, dhe së fundi kuintili i indeksit të pasurisë së ekonomisë familjare

rritet për një njësi dhe të gjithë variablat e tjerë mbeten konstante. Meqenëse probit është një model jolinear, ky efekt do të ndryshojë nga individi në individ. Prandaj, efekti mesatar marginal është thjesht mesatarja e efekteve individuale. Gabimet standarde të grupuara janë dhënë në kolonën e tretë. Rezultati z dhe probabiliteti përkatës jepen në kolonat katër dhe pesë. Dy kolonat e mëposhtme të tabelës ofrojnë vlerësimet e popullatës të kufirit të poshtëm dhe të sipërm në 95 për qind të besueshmërisë statistikore. Kolona e fundit jep një tregues nëse vlerësimi është statistikisht i rëndësishëm.

Në shikim të parë, përcaktuesit e vetëm statistikisht të rëndësishëm të punës së fëmijëve janë moshë, gjinia, dhe vendbanimi. Më konkretisht, të qenit djalë është e lidhur me një rritje të probabilitetit të të qenit në punë të fëmijëve prej 1.2 pikë përqindje mesatarisht, me kusht që gjithçka tjetër mbetet konstante. Për më tepër, të jetuarit në një ekonomi familjare në zonat rurale është e lidhur me një rritje të probabilitetit të të qenit në punën e fëmijëve prej 1.6 pikë përqindjeje mesatarisht, me kusht që gjithçka tjetër mbetet konstante. Interpretimi i moshës është paksa më i ndryshëm pasi shfaqet në mënyrë jolineare për shkak të termit të moshës në katror në rreshtin e tretë të tabelës. Duke qenë se shumica e dy variablave është pozitive, mjafton të thuhet se fëmijët më të rritur kanë më shumë gjasa të jenë në punë të fëmijëve, por kjo lidhje bëhet më e dobët me rritjen e fëmijës.

► **Tabela 4.1. Probabiliteti i të qenit në punën e fëmijëve, efektet mesatare marginale, në përgjithësi në Kosovë**

	Efekti marginal	Gabim standard	z	P>z	[95% intervali i besueshmërisë]	Signifikanca (Rëndësia)	
<b>Moshë</b>	6.0	17.4	58.8	9.8	12.2	0.019	***
<b>Moshë<sup>2</sup></b>	6.9	18.8	56.0	8.2	9.4	0.000	***
<b>Mashkull</b>	7.6	18.8	56.0	9.0	10.2	0.020	***
<b>Shqiptar</b>	-0.010	0.006	-1.860	0.063	-0.021	0.001	*
<b>Rural</b>	0.016	0.005	3.460	0.001	0.007	0.024	***
<b>Madhësia e ekonomisë familjare</b>	0.000	0.001	-0.550	0.579	-0.002	0.001	
<b>Jetim</b>	0.012	0.009	1.300	0.193	-0.006	0.031	
<b>Pa prind biologjik</b>	0.009	0.006	1.450	0.148	-0.003	0.022	
<b>Diferenca funksionale</b>	-0.001	0.007	-0.160	0.875	-0.014	0.012	
<b>Qasje në ujë</b>	-0.006	0.004	-1.580	0.115	-0.014	0.002	
<b>Kryefamiljari me arsim të lartë</b>	-0.005	0.006	-0.840	0.399	-0.016	0.006	
<b>Kuintili i indeksit të pasurisë</b>							
<b>I dytë</b>	-0.005	0.005	-0.930	0.353	-0.016	0.006	
<b>I mesëm</b>	-0.006	0.006	-0.960	0.338	-0.017	0.006	
<b>I katërt</b>	-0.010	0.006	-1.720	0.086	-0.021	0.001	*
<b>Më i pasur</b>	0.001	0.007	0.130	0.895	-0.013	0.015	

*Shënime: Madhësia e mostrës: N=5,322. Gabimet standarde të forta të grupuara. \*\*\* I rëndësishëm në 10%. \*\* I rëndësishëm në 5%. \* I rëndësishëm në 1%.*

Në të vërtetë, asnjë nga rezultatet e listuara më sipër nuk duhet të marrë një shpjegim shkakor në vetvete. Duhet të theksohet se të dhënat nuk ofrojnë dëshmi të mjaftueshme për një lidhje statistikisht të rëndësishme midis probabilitetit të të qenit në punën e fëmijëve dhe variablave të tjerë, duke përfshirë pasurinë e familjes dhe sfondin arsimor të familjes. Përsëri, kjo nuk do të thotë se këta nuk janë faktorë përcaktues të rëndësishëm; një arsye pse këto vlerësime janë të parëndësishme mund të jetë mostra e vogël dhe vëzhgimet e pakta të fëmijëve të përfshirë në punën e fëmijëve.

E njëjta analizë është aplikuar për 2,086 fëmijë nga grupi i të dhënave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Tabela 4.2 paraqet rezultatet e probit; interpretimi i kolonave mbetet i njëjtë. Ngjashëm me rezultatet e përgjithshme, të qenit djalë në këto komunitete është e lidhur me një rritje të probabilitetit të të qenit në punën e fëmijëve me 1.6 pikë përqindje mesatarisht, me kusht që gjithçka tjetër mbetet konstante. Në këtë rast, rritja e moshës së fëmijës shoqërohet gjithashtu me një efekt të kundërt të formës U në shanset për të qenë në punën e fëmijëve.

Është interesante se për këtë nëngrup fëmijësh, të pasurit prindër apo kujdestarë me vështirësi funksionale është e lidhur me një rritje të probabilitetit të të qenit në punën e fëmijëve me 1.5 pikë përqindje mesatarisht, me kusht që gjithçka tjetër mbetet konstante. Për më tepër, një rritje prej një njësi në madhësinë e ekonomisë familjare të fëmijës dhe të pasurit e qasjes në ujë është e lidhur me një ulje prej 0,6 dhe 1,6 pikë përqindjeje mesatarisht në probabilitetin për të qenë në punë të fëmijëve. Si më sipër, pasuria e ekonomisë familjare nuk duket të jetë statistikisht e lidhur me probabilitetin e të qenit në punë të fëmijëve pas kontrollit për këto karakteristika të ndryshme individuale dhe të ekonomisë familjare.

► **Tabela 4.2. Probabiliteti i të qenit në punën e fëmijëve, efektet mesatare marginale, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**

	Efekt i marginal	Gabimi standard	z	P>z	[95% intervali i besueshmërisë]		Signifikanca (Rëndësia)
<b>Mosha</b>	0.011	0.007	1.650	0.099	-0.002	0.024	*
<b>Mosha<sup>2</sup></b>	0.000	0.000	-1.650	0.099	-0.001	0.000	*
<b>Mashkull</b>	0.016	0.007	2.140	0.032	0.001	0.030	**
<b>Rural</b>	0.003	0.007	0.450	0.654	-0.011	0.017	
<b>Madhësia e ekonomisë</b>	-0.006	0.002	-3.020	0.003	-0.010	-0.002	***
<b>Jetim</b>	-0.028	0.023	-1.220	0.223	-0.073	0.017	
<b>Pa prind biologjik</b>	-0.003	0.013	-0.250	0.804	-0.030	0.023	
<b>Diferenca</b>	0.015	0.008	1.750	0.080	-0.002	0.031	*
<b>Qasje në ujë</b>	-0.016	0.008	-1.960	0.050	-0.032	0.000	*
<b>Kuintili i indeksit të pasurisë</b>							
<b>I dytë</b>	0.003	0.011	0.270	0.784	-0.018	0.024	
<b>I mesëm</b>	-0.003	0.010	-0.290	0.770	-0.023	0.017	
<b>I katërt</b>	-0.001	0.011	-0.110	0.909	-0.022	0.020	
<b>Më i pasur</b>	-0.003	0.011	-0.240	0.811	-0.025	0.019	

*Shënime: Madhësia e mostrës: N=2,086. Gabimet standarde të forta të grupuara. \*\*\* I rëndësishëm në 10%. \*\* I rëndësishëm në 5%. \* I rëndësishëm në 1%.*



## ► 5. Implikimet e punës së fëmijëve në edukimin dhe shëndetin e tyre

---


Anketat e MICS kanë shtuar së fundmi module të reja që fokusohen në aspekte të ndryshme të edukimit dhe shëndetit të fëmijëve. Pyetjet mbulojnë përfshirjen e prindërve në aktivitetet edukative të fëmijëve, shkathtësitë themelore në leximit dhe aritmetikë-aritmetikë dhe nëse ata përballen me ndonjë vështirësi në dimensione të ndryshme fizike, sociale dhe mendore. Këto module zbatohen vetëm për fëmijët e moshës 7-14 vjeç. Andaj, të gjitha rezultatet në këtë seksion i referohen asaj grupmoshe. Vëmendje e veçantë i kushtohet mënyrës sesi puna e fëmijëve lidhet dhe ndikon në këto aspekte të ndryshme të edukimit dhe shëndetit të fëmijëve. Në nënseksionet e mëposhtme, shifrat përshkruese dhe analiza e regresionit përdoren për të evidentuar pasojat potencialisht të dëmshme të punës së fëmijëve.

### 5.1. Arsimi

Moduli i të shkathtësive themelore në anketat e MICS-së vlerëson rezultatet në lexim dhe aritmetikë për fëmijët e moshës së shkollës filllore dhe të mesme të ulët (7-14), pavarësisht nëse ata vijnë në shkollën apo jo. Për më tepër, moduli i përfshirjes së prindërve fokusohet në mjedisin mësimor të fëmijëve në shtëpi dhe përfshirjen e prindërve në edukimin e tyre. Këto dy module ofrojnë një bazë solide të provave të nevojshme për të përmirësuar arsimin për fëmijët, veçanërisht në mesin e më të rrezikuarve, siç janë ata në punën e fëmijëve.

Është e njohur mirë se pjesëmarrja e prindërve në shkollimin e fëmijëve të tyre përmirëson rezultatet e tyre të të nxënësve. Për shembull, leximi në shtëpi përmirëson ndjeshëm aftësitë e të lexuarit, të kuptuarit dhe aftësitë gjuhësore shprehëse (Gest et al. 2004). Përveç kësaj, studimet tregojnë se mbështetja e prindërve për zhvillimin e leximit të fëmijëve të tyre është një tregues afatgjatë i besueshëm i suksesit eventual arsimor (Fluori dhe Buchanan 2004). Kështu, është thelbësore të shqyrtohet se si ndryshon përfshirja e prindërve në varësi të faktit nëse fëmija është në punën e fëmijëve.

Figura 5.1 tregon se vetëm 10.5 përqind të fëmijëve në përgjithësi dhe 9.5 përqind të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë u është lexuar nga prindërit ose kujdestarët e tyre . Përveç kësaj, përafërsisht një në tre fëmijë nga Kosova dhe një në katër nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës kanë marrë ndihmë me detyrat e shtëpisë. Fëmijët në punën e fëmijëve për Kosovën në përgjithësi kanë pak më shumë gjasa që t'u lexohet dhe dukshëm më shumë gjasa të marrin ndihmë me detyrat e shtëpisë. Një interpretim është se ata kanë më shumë nevojë për këtë ndihmë, prandaj e marrin atë. Dallimi në përfshirjen e prindërve në bazë të statusit të punës së fëmijëve nuk është aq i dukshëm për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.


► **Figura 5.1. Përfshirja e prindërve për fëmijët e moshës 7-14 vjeç, sipas statusit të punës së fëmijëve**

Duke qenë se fëmijët në punën e fëmijëve duket se marrin më shumë ndihmë, kjo mund të tregojë se ata kanë mbetur prapa. Ky i fundit është një informacion thelbësor në rastin e Kosovës, ku vijimi i shkollës nuk duket të jetë një shqetësim i madh në radhët e fëmijëve që punojnë. Me fjalë të tjera, shkollët e larta të vijimit të shkollës nga fëmijët mund të fshehin pasojat negative të punës së fëmijëve pa një pasqyrë të plotë të rezultateve të tyre arsimore. Kështu, paragrafët e mëposhtëm do të fokusohen në aftësitë e fëmijëve dhe statusin e tyre të punës së fëmijëve.

Ekzistojnë disa aftësi leximi të matura nga anketat e MICS-së. E para përkufizohet si leximi i saktë i 90 për qind të fjalëve në një tregim të caktuar; e dyta mat nëse fëmija mund t'i përgjigjet saktë tre pyetjeve të të kuptuarit të drejtëpërdrejtë, ndërsa e treta regjistron fëmijët që u përgjigjen saktë dy pyetjeve të të kuptuarit inferencial. Fëmijët klasifikohen si me shkathtësi themelore të leximit nëse i përmbushin të tria aftësitë e lartpërmendura.

Figura 5.2 tregon se fëmijët që punojnë kanë më pak gjasa të kenë secilën nga tre aftësitë e leximit në krahasim me fëmijët që nuk punojnë. Për më tepër, vetëm 36.7 për qind e fëmijëve në punën e fëmijëve kanë shkathtësi themelore, në krahasim me 42.2 për qind të fëmijëve që nuk janë në punën e fëmijëve. Në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, dukshëm më pak fëmijë kanë ndonjë nga tre aftësitë themelore të leximit; Figura 5.3 tregon se vetëm një në pesë fëmijë të këtyre komuniteteve kanë shkathtësi themelore të leximit. Megjithatë, hendeku i punës së fëmijëve në aftësitë e leximit në mesin e fëmijëve të këtyre komuniteteve nuk është aq i shprehur sa ai në përgjithësi në Kosovë. Performanca e ulët e leximit duket të jetë një çështje e përhapur në mesin e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë pavarësisht nga statusi i tyre i punës.

► Figura 5.2. Aftësitë e të lexuarit dhe puna e fëmijëve, fëmijët e moshës 7-14 vjeç, në përgjithësi në Kosovë



► Figura 5.3. Aftësitë e të lexuarit dhe puna e fëmijëve, fëmijët e moshës 7-14 vjeç, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian




Figura 5.2 dhe 5.3 ofrojnë vetëm korrelacione të përgjithshme midis variablave dhe nuk kontrollojnë për karakteristika të tjera të ekonomisë familjare dhe individuale që mund të nxisin aftësitë arsimore edhe vendimet për punën e fëmijëve. Kështu, një analizë regresioni mund të sigurojë një vlerësim më të saktë të implikimit të punës së fëmijëve për performancën arsimore. Tabela 5.1 jep rezultatet nga një regresion probit mbi probabilitetin që një fëmijë të ketë shkathhtësi themelore të leximit.

Gjetja kryesore është se të qenit në punën e fëmijëve lidhet me një rënie prej 6.7 pikë përqindjeje në probabilitetin për të pasur shkathhtësi themelore të leximit duke marrë parasysh dallimet në karakteristika individuale dhe të ekonomisë familjare. Faktorë të tjerë që ndikojnë negativisht në aftësitë e të lexuarit janë të jetuarit në zonat rurale dhe në ekonomi familjare të mëdha. Nga ana tjetër, vijimi i shkollës, të pasurit kryefamiljarë më të arsimuar, të qenit shqiptar dhe të qenit më i rritur, të gjitha rrisin gjasat për të pasur shkathhtësi themelore të leximit. Për shembull, një fëmijë me një kryefamiljar me të paktën arsim të lartë ka mesatarisht 9.3 pikë përqindjeje më shumë gjasa të ketë shkathhtësi themelore të leximit sesa një fëmijë, kryefamiljari i të cilit është më pak i arsimuar, me kusht që të gjitha të tjerat variabla mbeten konstante. Sipas tabelës, të qenit nga ekonomitë familjare më të pasura ka gjithashtu një korrelacion pozitiv shumë domethënës me performancën në lexim, me kusht që gjithçka tjetër mbetet e njëjtë.

► **Tabela 5.1. Probabiliteti i të pasurit të aftësive themelore të leximit, efektet mesatare margjinale, në përgjithësi në Kosovë**

	Efekti margjinal	Gabimi standard	z	P>z	[95% interval i besueshmërisë]	Signifikanca (Rëndësia)
<b>Puna e fëmijëve</b>	-0.067	0.037	-1.790	0.074	-0.140 0.006	*
<b>Mosha</b>	0.508	0.042	12.230	0.000	0.427 0.589	***
<b>Mosha<sup>2</sup></b>	-0.022	0.002	-11.330	0.000	-0.026 -0.018	***
<b>Mashkull</b>	-0.023	0.018	-1.260	0.209	-0.059 0.013	
<b>Shqiptar</b>	0.071	0.035	2.000	0.046	0.001 0.140	**
<b>Rural</b>	-0.047	0.020	-2.300	0.022	-0.087 -0.007	**
<b>Madhësia e ekonomisë familjare</b>	-0.011	0.004	-2.610	0.009	-0.019 -0.003	***
<b>Qasje në ujë</b>	-0.015	0.020	-0.730	0.464	-0.054 0.024	
<b>Kryefamiljari me arsim të lartë</b>	0.093	0.026	3.530	0.000	0.041 0.145	***
<b>Vijimi i shkollës</b>	0.297	0.1207	2.470	0.014	0.061 0.532	***
<b>Kuintili i indeksit të pasurisë</b>						
<b>I dytë</b>	0.093	0.026	3.530	0.000	0.041 0.145	***
<b>I mesëm</b>	0.125	0.030	4.200	0.000	0.067 0.184	***
<b>I katërt</b>	0.144	0.030	4.880	0.000	0.086 0.202	***
<b>Më i pasuri</b>	0.068	0.032	2.150	0.032	0.006 0.130	**

*Shënime: Madhësia e mostrës: N=1,199. Gabime standarde të forta të grupuara. \*\*\* I rëndësishëm në 10%. \*\* I rëndësishëm në 5%. \* I rëndësishëm në 1%.*

Tabela 5.2 përsërit të njëjtën analizë për grupin e të dhënave të fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Duke qenë se nuk kishte dallime të konsiderueshme në aftësitë e leximit të fëmijëve që punojnë kundrejt pjesës tjetër të fëmijëve, koeficienti statistikiqsh i parëndësishëm i punës së fëmijëve në lexim i paraqitur në tabelë është i pritshëm. Në këtë rast, të qenit më i rritur gjithashtu përmirëson, mesatarisht, gjasat për të pasur shkathtësi themelore të leximit, me kusht që gjithçka tjetër është konstante. Për dallim nga kjo, të qenit djalë lidhet me një rënie prej 8.8 pikë përqindjeje në probabilitetin për të pasur shkathtësi themelore të leximit. Për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë, të qenit nga ekonomi familjare më të pasura gjithashtu rrit gjasat për performancë të mirë në lexim, siç tregojnë koeficientët pozitivë statistikiqsh të rëndësishëm në tabelën 5.2.



► **Tabela 5.2. Probabiliteti për të pasur shkathtësi themelore të leximit, efektet mesatare margjinale, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**


	Efekti marginal	Gabimi standard	z	P>z	[95% Intervali i besueshmërisë]	Signifikanca (Rëndësia)	
<b>Puna e fëmijëve</b>	-0.003	0.050	-0.060	0.954	-0.101	0.096	
<b>Mosha</b>	0.292	0.062	4.690	0.000	0.170	0.413	***
<b>Mosha<sup>2</sup></b>	-0.013	0.003	-4.370	0.000	-0.018	-0.007	***
<b>Mashkull</b>	-0.088	0.027	-3.310	0.001	-0.140	-0.036	***
<b>Rural</b>	-0.020	0.028	-0.740	0.458	-0.075	0.034	
<b>Madhësia e ekonomisë familjare</b>	0.005	0.007	0.810	0.420	-0.008	0.018	
<b>Qasje në ujë</b>	-0.025	0.035	-0.720	0.470	-0.094	0.043	
<b>Kuintili i indeksit të pasurisë</b>							
<b>I dytë</b>	0.059	0.035	1.700	0.090	-0.009	0.127	*
<b>I mesëm</b>	0.085	0.038	2.260	0.024	0.011	0.159	**
<b>I katërt</b>	0.245	0.042	5.900	0.000	0.163	0.326	***
<b>Më i pasuri</b>	0.204	0.045	4.500	0.000	0.115	0.293	***

*Shënime: Madhësia e mostrës: N=393. Gabimet standarde të forta të grupuara. \*\*\* I rëndësishëm në 10%. \*\* I rëndësishëm në 5%. \* I rëndësishëm në 1%.*


Moduli i të shkathtësive themelore i MICS mbulon gjithashtu aftësitë në aritmetikësaritmetikë. Aftësia e parë në këtë grup mat nëse fëmija mund të kryejë me sukses një detyrë të leximit të numrave, ndërsa e dyta shënon përfundimin me sukses të një detyre të diskriminimit numerik. Aftësia e mëposhtme fokusohet në kompetencat shtesë dhe aftësia përfundimtare mat nëse fëmija mund të kryejë një detyrë njohjeje dhe përfundimi të modelit. Ashtu si aftësitë themelore të leximit, një fëmijë kategorizohet se ka shkathtësi themelore aritmetikësaritmetike nëse ka të gjitha aftësitë e lartpërmendura.

Figura 5.4 tregon se më pak se gjysma e fëmijëve në Kosovë kanë shkathtësi themelore të aritmetikësaritmetikës, dhe kjo shifër është edhe më e ulët për fëmijët në punë. Rreth 42.7 për qind e fëmijëve që nuk janë në punën e fëmijëve kanë shkathtësi themelore aritmetike në krahasim me 37.1 për qind të atyre që janë në punën e fëmijëve. Për më tepër, fëmijët e përfshirë në punën e fëmijëve kanë më pak gjasa të kenë secilën nga katër aftësitë e aritmetikësaritmetikës. Figura 5.5 paraqet një situatë të rëndë për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian; më pak se 14 për qind e fëmijëve kanë shkathtësi themelore të aritmetikës në këto komunitete. Për më tepër, vetëm 6.8 për qind e fëmijëve të përfshirë në punën e fëmijëve kanë shkathtësi themelore të aritmetikësaritmetikës.

► **Figura 5.4. Aftësitë e aritmetikës dhe puna e fëmijëve, fëmijët e moshës 7-14 vjeç, në përgjithësi në Kosovë**



► **Figura 5.5. Aftësitë e aritmetikës dhe puna e fëmijëve, fëmijët e moshës 7-14 vjeç, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**



Përderisa të dhënat ofrojnë dëshmi të korrelacionit negativ midis punës së fëmijëve dhe aftësive të aritmetikës, analiza e regresionit mund të ofrojë vlerësime më të sakta. Tabela 5.3 tregon se edhe pasi merren parasysh dallimet në karakteristika të ndryshme individuale dhe të ekonomisë familjare, të qenit në punën e fëmijëve lidhet me një rënie prej 6.7 pikë përqindjeje në probabilitetin e një fëmije për të pasur shkathtësi themelore të aritmetikës. Për më tepër, të qenit djalë dhe shqiptar rrit gjasat e aftësive themelore të aritmetikës mesatarisht me 5.5 dhe 17.1 pikë përqindjeje, me kusht që të gjitha të tjerat janë konstante. Siç pritej, të pasurit e një kryefamiljari me arsim të lartë dhe të qenit nga një ekonomi familjare më e pasur lidhet gjithashtu me gjasa më të larta për të pasur shkathtësi themelore të aritmetikës, me kusht që gjithçka tjetër mbetet konstante. Mesatarisht, fëmijët nga zonat rurale performojnë më keq në aftësitë e aritmetikës kur merren parasysh karakteristikat individuale dhe të ekonomisë familjare.

► Tabela 5.3. Probabiliteti për të pasur shkathtësi themelore të aritmetikës, efektet mesatare margjinale, në përgjithësi në Kosovë

	Efekti margjinal	Gabimi standard	z	P>z	[95% Intervali i besueshmërisë]		Signifikanca (Rëndësia)
<b>Puna e fëmijëve</b>	-0.067	0.037	-1.790	0.074	-0.140	0.007	*
<b>Mosha</b>	0.504	0.042	12.110	0.000	0.423	0.586	***
<b>Mosha<sup>2</sup></b>	-0.022	0.002	-11.150	0.000	-0.026	-0.018	***
<b>Mashkull</b>	0.055	0.018	2.990	0.003	0.019	0.090	***
<b>Shqiptar</b>	0.171	0.036	4.710	0.000	0.100	0.242	***
<b>Rural</b>	-0.082	0.020	-4.070	0.000	-0.122	-0.042	***
<b>Madhësia e ekonomisë familjare</b>	0.003	0.004	0.690	0.493	-0.005	0.011	
<b>Qasje në ujë</b>	0.001	0.020	0.040	0.972	-0.038	0.040	
<b>Kryefamiljari me arsim të lartë</b>	0.134	0.024	5.540	0.000	0.087	0.182	***
<b>Kuintili i indeksit të pasurisë</b>							
<b>I dytë</b>	0.080	0.026	3.030	0.002	0.028	0.132	***
<b>I mesëm</b>	0.084	0.030	2.810	0.005	0.025	0.143	***
<b>I katërt</b>	0.053	0.029	1.820	0.069	-0.004	0.110	*
<b>Më i pasuri</b>	0.154	0.032	4.810	0.000	0.091	0.217	***

Shënime: Madhësia e mostrës: N=1,199. Gabimet standarde të forta të grupuara. \*\*\* I rëndësishëm në 10%. \*\* I rëndësishëm në 5%. \* I rëndësishëm në 1%.

Tabela 5.4 paraqet të njëjtën analizë të bërë në grupin e të dhënave të fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Pasojat e punës së fëmijëve në probabilitetin e të pasurit të aftësive themelore të aritmetikës është edhe më domethënëse për këtë grup. Të qenit në punën e fëmijëve shoqërohet me një rënie prej 9.5 pikë përqindjeje në gjasat për të pasur shkathtësi themelore të aritmetikës mesatarisht. Ngjashëm me rezultatet e mëparshme, të qenit djalë, të pasurit e kryefamiljarit më të arsimuar dhe të qenit nga ekonomi familjare më të pasura duket se rrisin gjasat për të pasur sukses në aftësitë e aritmetikës.

► **Tabela 5.4. Probabiliteti për të pasur shkathtësi themelore të aritmetikës, efektet mesatare margjinale, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**

	Efekt i marginal	Gabimi standard	z	P>z	[95% Intervali i besueshmërisë]		Rëndësia
<b>Puna e fëmijëve</b>	-0.095	0.051	-1.850	0.064	-0.196	0.006	*
<b>Mosha</b>	0.212	0.055	3.850	0.000	0.104	0.320	***
<b>Mosha<sup>2</sup></b>	-0.009	0.003	-3.590	0.000	-0.014	-0.004	***
<b>Mashkull</b>	0.108	0.024	4.450	0.000	0.061	0.156	***
<b>Rural</b>	0.017	0.024	0.690	0.487	-0.031	0.064	
<b>Madhësia e ekonomisë familjare</b>	0.000	0.006	0.000	0.996	-0.011	0.011	
<b>Qasje në ujë</b>	0.027	0.031	0.860	0.389	-0.034	0.089	
<b>Kryefamiljari me arsim të lartë</b>	0.135	0.024	5.550	0.000	0.087	0.182	***
<b>Kuintili i Indeksit të Pasurisë</b>							
<b>I dytë</b>	0.044	0.028	1.580	0.114	-0.011	0.099	
<b>I mesëm</b>	0.139	0.036	3.900	0.000	0.069	0.209	***
<b>I katërt</b>	0.170	0.036	4.760	0.000	0.100	0.240	***
<b>Më i pasuri</b>	0.098	0.036	2.740	0.006	0.028	0.168	***


Shënime: Madhësia e mostrës: N=393. Gabimet standarde të forta të grupuara. \*\*\* I rëndësishëm në 10%. \*\* I rëndësishëm në 5%. \* I rëndësishëm në 1%.

## 5.2. Shëndeti


Bazuar në gjetjet e mësipërme, ka prova thelbësore që fëmijët në punën e fëmijëve janë mesatarisht më keq në aftësitë e tyre të leximit dhe të aritmetikës. Arritje arsimore dhe progresi i fëmijëve pësojnë nga angazhimi i tyre në punën e fëmijëve. Megjithatë, shëndeti është po aq i domosdoshëm për edukimin dhe prosperitetin e tyre në të ardhmen. Prandaj, paragrafët vijues do të fokusohen në implikimet e punës së fëmijëve për aspektet e ndryshme të shëndetit fizik, social dhe mendor të fëmijëve, të regjistruara gjithashtu nga anketat e MICS për të gjithë fëmijët e moshës 5-17 vjeç.

Të pasurit e një vështirësie funksionale për fëmijët e moshës 5-17 vjeç përkufizohet si një fëmijë që është përgjigjur me “Shumë vështirësi” ose “Nuk mund fare” për çdo pyetje brenda të paktën një prej fushave funksionale<sup>4</sup>. Figura 5.5 dhe 5.6 nuk tregojnë dallime thelbësore në përqindjen e fëmijëve me vështirësi funksionale bazuar në statusin e tyre të punës së fëmijëve për fëmijët në përgjithësi në Kosovë dhe në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Për shembull, 9 për qind e fëmijëve që nuk janë në punën e fëmijëve kanë vështirësi funksionale në krahasim me 7 për qind të fëmijëve në punën e fëmijëve. Megjithatë, në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, ka një përqindje dukshëm më të lartë të fëmijëve me vështirësi funksionale në përgjithësi. Për shembull, rreth 16 për qind e fëmijëve që nuk janë në punën e fëmijëve kanë vështirësi funksionale, në krahasim me 20 për qind të fëmijëve që janë në punën e fëmijëve në këto komunitete.

► Figura 5.6. Vështirësi funksionale dhe puna e fëmijëve, fëmijët e moshës 5-17 vjeç, në përgjithësi në Kosovë



► Figura 5.7. Vështirësitë funksionale dhe puna e fëmijëve, fëmijët e moshës 5-17 vjeç, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian



Të dhënat nuk ofrojnë dëshmi të mjaftueshme për implikimet negative të punës së fëmijëve në vështirësitë funksionale të fëmijëve. Megjithatë, analiza e mëtejshme e regresionit ofrohet për të testuar marrëdhënien midis punës së fëmijëve dhe shëndetit. Tabela 5.5 jep rezultatet e një probit mbi probabilitetin për të pasur vështirësi funksionale. Siç pritej, puna e fëmijëve nuk ka një lidhje statistike të rëndësishme me vështirësitë funksionale edhe pas kontrollit për karakteristika të ndryshme individuale dhe të ekonomisë familjare. Mesatarisht, një sërë faktorësh të tjerë lidhen me një probabilitet të zvogëluar për të pasur vështirësi funksionale, si të qenit djalë, të qenit nga zona rurale ose ekonomi familjare më të pasura dhe vijimi i shkollës.

<sup>4</sup> Fushat funksionale të mbuluara në anketat e MICS janë: shikimi, dëgjimi, ecja, kujdesi për veten, komunikimi, të mësuarit, kujtesa, përqendrimi, pranimi i ndryshimit, kontrolli i sjelljes, krijimi i shokëve/shoqeve, ankthi dhe depresioni

► **Tabela 5.5. Probabiliteti për të pasur vështirësi funksionale, efektet mesatare margjinale , në përgjithësi në Kosovë**

	Efekti margjinal	Gabimi standard	z	P>z	[95% Intervali i besueshmërisë]	Rëndësia
<b>Puna e fëmijëve</b>	-0.018	0.019	-0.950	0.343	-0.056 0.019	
<b>Mosha</b>	0.003	0.008	0.390	0.699	-0.012 0.018	
<b>Mosha<sup>2</sup></b>	0.000	0.000	-0.240	0.807	-0.001 0.001	
<b>Mashkull</b>	-0.021	0.008	-2.620	0.009	-0.037 -0.005	***
<b>Shqiptar</b>	-0.006	0.014	-0.470	0.641	-0.033 0.020	
<b>Rural</b>	-0.023	0.009	-2.550	0.011	-0.040 -0.005	**
<b>Madhësia e ekonomisë familjare</b>	0.001	0.002	0.520	0.602	-0.002 0.004	
<b>Qasje në ujë</b>	-0.013	0.009	-1.510	0.130	-0.031 0.004	
<b>Kryefamiljari me arsim të lartë</b>	-0.005	0.012	-0.410	0.679	-0.028 0.018	
<b>Vijimi i shkollës</b>	-0.054	0.017	-3.190	0.001	-0.087 -0.021	***
<b>Kuintili i indeksit të pasurisë</b>						
<b>I dytë</b>	-0.005	0.006	-0.840	0.399	-0.016 0.006	
<b>I mesëm</b>						
<b>I katërt</b>	-0.042	0.013	-3.270	0.001	-0.068 -0.017	***
<b>Më i pasuri</b>	-0.029	0.014	-2.050	0.040	-0.057 -0.001	**

*Shënime: Madhësia e mostrës: N= 2,381 . Gabimet standarde të forta të grupuara. \*\*\* I rëndësishëm në 10%. \*\* I rëndësishëm në 5%. \* I rëndësishëm në 1%.*

Tabela 5.6 ofron të njëjtën analizë por mbi të dhënat nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Edhe në këtë rast, koeficienti për punën e fëmijëve nuk është statistikisht i rëndësishëm. Megjithatë, për këtë grup fëmijësh, fëmijët më të rritur dhe ata që vijnë shkollën kanë, mesatarisht, më pak të ngjarë të kenë vështirësi funksionale, me kusht që gjithçka tjetër është konstante. Marrëdhënia midis pasurisë së ekonomisë familjare dhe vështirësisë funksionale të fëmijës nuk është aq e fortë në këto komunitete.

► **Tabela 5.6. Probabiliteti për të pasur vështirësi funksionale, efektet mesatare marginale, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**

	Efkti marginal	Gabimi standard	z	P>z	[95% Intervali i besueshmërisë]		Rëndësia
<b>Puna e fëmijëve</b>	0.017	0.032	0.530	0.596	-0.045	0.079	
<b>Mosha</b>	-0.038	0.015	-2.540	0.011	-0.068	-0.009	**
<b>Mosha<sup>2</sup></b>	0.002	0.001	2.520	0.012	0.000	0.003	**
<b>Mashkull</b>	-0.001	0.016	-0.080	0.937	-0.033	0.031	
<b>Shqiptar</b>	-0.006	0.022	-0.280	0.781	-0.049	0.037	
<b>Rural</b>	0.024	0.017	1.440	0.151	-0.009	0.056	
<b>Madhësia e ekonomisë familjare</b>	-0.001	0.004	-0.160	0.872	-0.008	0.006	
<b>Qasje në ujë</b>	-0.051	0.020	-2.560	0.010	-0.090	-0.012	
<b>Vijimi i shkollës</b>	-0.082	0.018	-4.430	0.000	-0.118	-0.046	***
<b>Kuintili i indeksit të pasurisë</b>							
<b>I dytë</b>	-0.063	0.023	-2.760	0.006	-0.107	-0.018	***
<b>I mesëm</b>	0.080	0.029	2.810	0.005	0.024	0.136	***
<b>I katërt</b>	-0.026	0.026	-1.010	0.311	-0.077	0.024	
<b>Më i pasuri</b>	-0.090	0.026	-3.520	0.000	-0.140	-0.040	

*Shënime: Madhësia e mostrës: N= 771 . Gabimet standarde të forta të grupuara. \*\*\* I rëndësishëm në 10%. \*\* I rëndësishëm në 5%. \* I rëndësishëm në 1%.*

Treguesi i vështirësisë funksionale në përbërjen e tij përmban ankthin dhe depresionin. Megjithatë, duke marrë parasysh ngarkesën emocionale të punës së fëmijëve tek fëmijët, paragrafët e mëposhtëm thellohen më shumë në ankthin dhe depresionin veç e veç. Tabelat 5.7 dhe 5.8 ofrojnë rezultatet nga regresionet probit mbi probabilitetin e përjetimit të ankthit çdo ditë për fëmijët në përgjithësi në Kosovë, përkatësisht për ata të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Ndryshe nga pritshmëritë, të qenit në punën e fëmijëve lidhet negativisht me ankthin mesatarisht për fëmijët në Kosovë pasi që merren parasysh dallimet në karakteristika individuale dhe të ekonomisë familjare. Megjithatë, ky rezultat nuk nënkupton domosdoshmërisht që puna e fëmijëve redukton ankthin tek fëmijët.

Një shpjegim alternativ mund të jetë se fëmijët me ankth nuk janë në gjendje të kryejnë ndonjë punë; për këtë arsye shohim edhe korrelacioni negativ. Në anën tjetër, koeficienti i punës së fëmijëve për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nuk është statistiki në rëndësishëm. Tabelat tregojnë gjithashtu se të qenit i rritur dhe të qenit shqiptar lidhen pozitivisht me ankthin, me kusht që gjithçka tjetër është konstante. Nga ana tjetër, ndjekja e shkollës, të qenit nga zonat rurale, qasja e ekonomisë familjare në ujë dhe pasuria e ekonomisë familjare janë të gjitha të lidhura negativisht me ankthin, me kusht që gjithçka tjetër është konstante. Rezultatet janë të ngjashme për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë, përveç se fëmijët më të rritur dhe ata që ndjekin shkollën kanë më shumë gjasa të përjetojnë ankth, me kusht që gjithçka tjetër është konstante.

► **Tabela 5.7 . Probabiliteti i përjetimit të ankthit , efektet mesatare marginale , në përgjithësi në Kosovë**

	Efkti marginal	Gabimi standard	z	P>z	[95% Intervali i besueshmërisë]		Rëndësia
<b>Puna e fëmijëve</b>	-0.043	0.019	-2.220	0.026	-0.081	-0.005	**
<b>Mosha</b>	0.011	0.006	1.830	0.068	-0.001	0.024	*
<b>Mosha<sup>2</sup></b>	0.000	0.000	-1.500	0.133	-0.001	0.000	
<b>Mashkull</b>	-0.003	0.007	-0.390	0.699	-0.015	0.010	
<b>Shqiptar</b>	0.030	0.013	2.350	0.019	0.005	0.056	**
<b>Rural</b>	-0.019	0.007	-2.590	0.010	-0.033	-0.005	**
<b>Madhësia e ekonomisë familjare</b>	-0.002	0.002	-1.380	0.167	-0.005	0.001	
<b>Qasje në ujë</b>	-0.015	0.007	-2.100	0.035	-0.029	-0.001	**
<b>Kryefamiljari me arsim të lartë</b>	0.003	0.009	0.350	0.727	-0.015	0.021	
<b>Vijimi i shkollës</b>	-0.031	0.013	-2.350	0.019	-0.057	-0.005	***
<b>Kuintili i indeksit të pasurisë</b>							
<b>I dytë</b>	-0.004	0.010	-0.430	0.669	-0.025	0.016	
<b>I mesëm</b>	0.006	0.012	0.510	0.608	-0.017	0.029	
<b>I katërt</b>	-0.018	0.011	-1.700	0.090	-0.039	0.003	*
<b>Më i pasuri</b>	-0.036	0.010	-3.630	0.000	-0.055	-0.016	***

*Shënime: Madhësia e mostrës: N= 2,381 . Gabimet standarde të forta të grupuara. \*\*\* I rëndësishëm në 10%. \*\* I rëndësishëm në 5%. \* I rëndësishëm në 1%.*



► **Tabela 5.8. Probabiliteti i përjetimit të ankthit, efektet mesatare margjinale, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**

	Efkti margjinal	Gabimi standard	z	P>z	[95% Intervali i besueshmërisë]		Rëndësia
<b>Puna e fëmijëve</b>	-0.035	0.024	-1.470	0.141	-0.081	0.012	
<b>Mosha</b>	0.025	0.011	2.280	0.022	0.004	0.047	**
<b>Mosha 2</b>	-0.001	0.000	-1.990	0.046	-0.002	0.000	**
<b>Mashkull</b>	0.019	0.011	1.650	0.099	-0.003	0.041	*
<b>Shqiptar</b>	0.013	0.011	1.160	0.244	-0.009	0.035	
<b>Rural</b>	-0.007	0.003	-2.680	0.007	-0.012	-0.002	***
<b>Madhësia e ekonomisë familjare</b>	-0.002	0.014	-0.130	0.898	-0.029	0.025	
<b>Qasje në ujë</b>	-0.035	0.024	-1.470	0.141	-0.081	0.012	
<b>Vijimi i shkollës</b>	0.000	0.000	-2.350	0.019	-0.001	0.000	***
<b>Kuintili i indeksit të pasurisë</b>							
<b>I dytë</b>	0.008	0.017	0.490	0.627	-0.025	0.041	
<b>I mesëm</b>	-0.010	0.017	-0.630	0.531	-0.043	0.022	
<b>I katërt</b>	0.008	0.018	0.440	0.663	-0.027	0.043	
<b>Më i pasuri</b>	-0.042	0.016	-2.730	0.006	-0.073	-0.012	***

*Shënime: Madhësia e mostrës: N= 771 . Gabimet standarde të forta të grupuara . \*\*\* I rëndësishëm në 10%. \*\* I rëndësishëm në 5%. \* I rëndësishëm në 1%.*

Tabelat 5.9 dhe 5.10 japin të njëjtën analizë si më sipër, por mbi probabilitetin për të përjetuar depresion çdo ditë. Përsëri, nuk ka prova të mjaftueshme për të përcaktuar një lidhje ndërmjet punës së fëmijëve dhe depresionit, as për fëmijët në përgjithësi në Kosovë, as për ata të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Megjithatë, bazuar në rezultatet, faktorët e këtyre dy grupeve që lidhen me përvojat e depresionit janë të ndryshëm. Nga njëra anë, tabela 5.9 tregon se të qenit nga zonat rurale ose ekonomitë familjare më të pasura, të pasurit e qasjes në ujë ose kryefamiljarëve të arsimuar dhe vijimi i shkollës janë të gjitha të lidhura me një ulje të probabilitetit për të përjetuar depresion çdo ditë mesatarisht, me kusht që gjithçka tjetër është konstante. Nga ana tjetër, tabela 5.10 tregon se për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, të qenit nga zonat rurale shoqërohet me një rritje të probabilitetit për të përjetuar depresion çdo ditë. Në të njëjtën kohë, lidhja me pasurinë e ekonomisë familjare nuk është aq e fortë mesatarisht, me kusht që gjithçka tjetër është konstante. Vijimi i shkollës duket se është i dobishëm në lidhje me depresionin për të dy grupet e fëmijëve.

► **Tabela 5.9. Probabiliteti i përjetimit të depresionit, efektet mesatare marginale , në përgjithësi në Kosovë**

	Efekti marginal	Gabimi standard	z	P>z	[95% Intervali i besueshmërisë]	Rëndësia
<b>Puna e fëmijëve</b>	-0.004	0.009	-0.410	0.683	-0.022 0.014	
<b>Mosha</b>	0.005	0.004	1.150	0.250	-0.003 0.012	
<b>Mosha<sup>2</sup></b>	0.000	0.000	-1.400	0.160	-0.001 0.000	
<b>Mashkull</b>	-0.009	0.004	-2.160	0.031	-0.017 -0.001	**
<b>Shqiptar</b>	0.006	0.007	0.830	0.405	-0.008 0.020	
<b>Rural</b>	-0.011	0.005	-2.310	0.021	-0.020 -0.002	**
<b>Madhësia e ekonomisë familjare</b>	0.000	0.001	-0.380	0.704	-0.002 0.001	
<b>Qasje në ujë</b>	-0.017	0.005	-3.750	0.000	-0.026 -0.008	***
<b>Kryefamiljari me arsim të lartë</b>	-0.013	0.007	-1.850	0.065	-0.027 0.001	*
<b>Vijimi i shkollës</b>	-0.015	0.008	-1.810	0.070	-0.032 0.001	**
<b>Kuintili i indeksit të pasurisë</b>						
<b>I dytë</b>	-0.011	0.007	-1.680	0.093	-0.024 0.002	*
<b>I mesëm</b>	-0.003	0.008	-0.350	0.723	-0.018 0.012	
<b>I katërt</b>	-0.016	0.007	-2.330	0.020	-0.029 -0.002	**
<b>Më i pasuri</b>	-0.019	0.007	-2.830	0.005	-0.031 -0.006	***

*Shënime: Madhësia e mostrës: N= 2,381 . Gabimet standarde të forta të grupuara. \*\*\* I rëndësishëm në 10%. \*\* I rëndësishëm në 5%. \* I rëndësishëm në 1%.*

► Tabela 5.10. Probabiliteti i përjetimit të depresionit, efektet mesatare marginale, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

	Efekt margjinal	Gabimi standard	z	P>z	[95% Intervali i besueshmërisë]	Rëndësia
<b>Puna e fëmijëve</b>	-0.008	0.020	-0.400	0.686	-0.047 0.031	
<b>Mosha</b>	-0.004	0.009	-0.390	0.695	-0.021 0.014	
<b>Mosha<sup>2</sup></b>	0.000	0.000	0.610	0.544	-0.001 0.001	
<b>Mashkull</b>	0.001	0.010	0.070	0.940	-0.018 0.020	
<b>Rural</b>	0.025	0.010	2.430	0.015	0.005 0.045	**
<b>Madhësia e ekonomisë familjare</b>	-0.001	0.002	-0.450	0.654	-0.005 0.003	
<b>Qasje në ujë</b>	-0.001	0.012	-0.080	0.936	-0.024 0.022	
<b>Vijimi i shkollës</b>	-0.014	0.011	-1.260	0.209	-0.035 0.008	***
<b>Kuintili i indeksit të pasurisë</b>						
<b>I dytë</b>	-0.018	0.014	-1.280	0.200	-0.045 0.009	
<b>I mesëm</b>	-0.010	0.015	-0.660	0.511	-0.041 0.020	
<b>I katërt</b>	-0.041	0.013	-3.230	0.001	-0.066 -0.016	***

Shënime: Madhësia e mostrës: N= 771 . Gabimet standarde të forta të grupuara. \*\*\* I rëndësishëm në 10%. \*\* I rëndësishëm në 5%. \* I rëndësishëm në 1%.



## ► 6. Përfundime

---

Puna e fëmijëve mbetet një fenomen shqetësues dhe i përhapur në Kosovë si dhe në mbarë botën. Ky raport ka synuar të rrisë ndërgjegjësimin dhe të informojë politikë-bërjen duke ofruar gjetjet më të fundit statistikore mbi këtë çështje. Më konkretisht, ai ka ofruar një pasqyrë përshkruese të **prevalencës, përcaktuesve** dhe **pasojave** të punës së fëmijëve bazuar në analizën statistikore përshkruese dhe të regresionit të Anketës së Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë të Kosovës (MICS) 2020.

Raporti ka gjetur se rreth 5.3 për qind e fëmijëve në Kosovë dhe 7 për qind e fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian ishin në punë të fëmijëve. Shumica e fëmijëve në Kosovë kombinonin shkollën dhe punën; Kështu, vijimi i shkollës nuk ishte shumë informues për pasojat për ata që janë në rrezik të punës së fëmijëve në Kosovë. Sidoqoftë, normat e të qenit jashtë shkollës mbeten shqetësuese për ata që tashmë janë në punën e fëmijëve. Për dallim nga kjo, fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë përballen me pengesa të ndryshme, ku “të mosbërit asgjë” e tyre – të mos qenit janë as në shkollë e as në punë – ishte në shkallë alarmante. Fëmijët në punën e fëmijëve shpenzonin 10.3 orë në punë në javë në përgjithësi në Kosovë. Përveç kësaj, fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptianë punonin pothuajse dy herë më shumë se fëmijët e tjerë në punën e fëmijëve në përgjithësi në Kosovë. Intensiteti kohor i punës së fëmijëve përkeqësohej teksa fëmijët rriten. Përveç kësaj, përfshirja në punët e shtëpisë rritej me moshën e fëmijës. Vajzat kishin shumë më shumë gjasa të angazhoheshin në punët e shtëpisë sesa djemtë. Pak fëmijë ishin të ekspozuar ndaj kushteve të rrezikshme në vendin e punës, por fëmijët e përfshirë në punën e fëmijëve kishin më shumë gjasa të vuanin nga kushte të tilla.

Analiza e regresionit zbuloi se përcaktuesit e vetëm statistikisht të rëndësishëm të punës së fëmijëve për fëmijët e Kosovës ishin moshja, të qenit djalë, të qenit nga zonat rurale dhe vijimi i shkollës. Vështirësitë funksionale të prindit apo kujdestarit ishin një faktor shtesë përcaktues i punës së fëmijëve për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Shkathtësitë e leximit dhe aritmetikës të fëmijëve duket se kanë hapësirë të konsiderueshme për përmirësim. Për më tepër, puna e fëmijëve i përkeqësonte gjërat pasi ulte ndjeshëm probabilitetin për të pasur shkathtësi themelore të leximit dhe aritmetikës. Për fat të mirë, puna e fëmijëve nuk dukej të ketë implikime të konsiderueshme për shëndetin e fëmijëve. Megjithatë, ky konstatim mund të ndryshojë nëse në tregues do të përfshihej puna e rrezikshme.

Këto gjetje janë të vlefshme pasi ato japin një pamje më të qartë mbi situatën e fëmijëve që janë të përfshirë në punën e fëmijëve dhe atyre në rrezik. Por, më e rëndësishmja, ato ofrojnë dëshmi të fuqishme të efektit të dëmshëm të punës së fëmijëve në përparimin arsimor të tyre. Ato duhet të shërbejnë si një thirrje për Qeverinë, shoqërinë civile dhe palët e tjera të interesuara që të ndër marrin veprime për të eliminuar punën e fëmijëve dhe për të përmirësuar arritjet arsimore të fëmijëve. Thirrja për veprim është edhe më urgjente duke pasur parasysh progresin e humbur për shkak të pandemisë COVID-19. Seksioni tjetër ofron disa rekomandime se si dhe ku mund të fillojmë.



## ▶ 7. Rekomandimet

---

Për të luftuar punën e fëmijëve në Kosovë, rekomandimet e mëposhtme mund të ndihmojnë në udhëzimin e përgjigjeve të politikave dhe dialogut mbi këtë çështje.

- ▶ Duke pasur parasysh korrelacionin negativ midis pasurisë së ekonomisë familjare dhe punës së fëmijëve, është jetike të zgjerohet mbrojtja sociale për fëmijët dhe familjet e tyre për të zbutur varfërinë dhe pasigurinë ekonomike që shërbejnë si bazë punën e fëmijëve. Raporti ofron informacion të bollshëm mbi profilin e fëmijëve të përfshirë në punën e fëmijëve dhe të atyre në rrezik. Kështu, politikat e mbrojtjes sociale mund të synojnë këto grupe për të rritur efikasitetin dhe ndikimin e skemave të tilla.
- ▶ Vajzat në Kosovë kishin barrën më të madhe në lidhje me punët e shtëpisë. Prandaj, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet normave gjinore dhe diskriminimit që rrisin rreziqet e punës së fëmijëve në sferën jopublike.
- ▶ Fëmijët nga zonat rurale ishin veçanërisht të rrezikuar nga puna e fëmijëve, performanca e dobët arsimore dhe rezultate të tjera negative. Prandaj rekomandohet përmirësimi i jetesës dhe qëndrueshmërisë rurale duke investuar në infrastrukturën që lidhet me mirëqenien dhe arsimin e fëmijëve, si dhe duke përmirësuar perspektivat e përgjithshme ekonomike të familjeve rurale.
- ▶ Vijimi i shkollës nuk ishte shqetësimi mbizotërues për fëmijët e Kosovës, por arritjet e tyre arsimore mbeten shumë prapa, veçanërisht për ata fëmijë që janë në punën e fëmijëve. Shkollimi në Kosovë vazhdon të jetë falas, por duhet bërë më shumë përpjekje për të rritur cilësinë e tij në mënyrë që të sigurojë një alternativë të qëndrueshme ndaj punës së fëmijëve dhe t'u ofrojë fëmijëve një shans për një të ardhme më të mirë. Për më tepër, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet sigurimit që fëmijët që punojnë të qëndrojnë në shkollë dhe të mos mbeten prapa në mësimet e tyre.
- ▶ Megjithatë, duhet të hartohen politika të veçanta për të siguruar vijimin e shkollës për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë. Mund të hartohen gjithashtu kurrikula unike për t'i ndihmuar ata të zënë hapin në aftësitë bazë të aritmetikës dhe leximit, duke pasur parasysh performancën e tyre të dobët sipas rezultateve të këtij raporti.
- ▶ Ndërsa hartimi i politikave dhe strategjive është hapi i parë për të trajtuar punën e fëmijëve, organet institucionale duhet të sigurojnë se ekzistojnë ligjet dhe rregulloret e nevojshme për të mbrojtur fëmijët, duke u mbështetur edhe nga zbatimi i duhur në terren.
- ▶ Rritja e fondit të njohurive mbi punën e fëmijëve në nivel kombëtar mund të ndihmojë në përcaktimin e prioritetëve lokale dhe në drejtimin e vendimeve të financimit dhe politikave. Qeveria e Kosovës, organizatat ndërkombëtare dhe vendore dhe shoqëria civile duhet të angazhohen në dialogun social për të ndërtuar politika efektive dhe të përgjegjshme për trajtimin e punës së fëmijëve dhe implikimeve të saj. Ky dialog duhet të udhëhiqet nga të dhëna dhe prova të forta. Përderisa ky raport ofron një pikënisje të shkëlqyer për diskutimin, kufizimet e tij gjithashtu theksojnë nevojën që Kosova të realizojë një anketë kombëtare për punën e fëmijëve.





## ► Referencat

---

Fluori, Eirini dhe Ann Buchanan. 2004 . “ Early Father’s and Mother’s Involvement and Child’s Later Educational Outcomes ” (Përfshirja e hershme e babait dhe nënës dhe rezultatet e mëvonshme arsimore të fëmijës). *British Journal of Educational Psychology* 74 (2): 141–153.

Gest, Scott D., Nicole R. Freeman, Celene E. Domitrovich dhe Janet A. Eelsh. 2004. “Shared Book Reading and Children’s Language Comprehension Skills: The Moderating Role of Parental Discipline Practices ” (Leximi i përbashkët i librave dhe aftësitë e të kuptuarit të gjuhës të fëmijëve”: Roli moderues i praktikave të disiplinës prindërore”. *Early Childhood Research Quarterly* 19 (2): 319–336.

GRETA (Grupi i Ekspertëve për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore). 2021. *Raporti i Dytë për Pajtueshmërinë e Kosovës me Standardet e Konventës së Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore. Strasburg: Këshilli i Evropës.*

ILO. 2020. “Analiza e kostove për menaxhimin e rasteve të punës së fëmijëve në Kosovë”.

— dhe UNICEF. 2021. *Puna e Fëmijëve: Vlerësimet Globale 2020, Trendet dhe Rruga Përpara*. [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed\\_norm/---ipecc/documents/publication/wcms\\_797515.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_norm/---ipecc/documents/publication/wcms_797515.pdf).

Zyra për Qeverisje të Mirë, Republika e Kosovës. “Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve 2019 – 2023”. <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/40542-UpdEn.pdf>.

UNICEF dhe ASK (Agjencia e Statistikave të Kosovës). 2020a. “Anketa e grupimeve të treguesve të shumëfishtë në Kosovë (MICS) 2019 – 2020”. <https://mic.s.unicef.org/surveys>.

— , — . 2020b. “Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë MICS 2019 – 2020”. <https://mics.unicef.org/surveys>.

USDOL (Departamenti i Punës i Shteteve të Bashkuara), Byroja e Çështjeve Ndërkombëtare të Punës . 2020. “Gjetjet e 2020 mbi format më të rënda të punës së fëmijëve”. <https://www.dol.gov/agencies/ilab/resources/reports/child-labor/kosovo>.



## ► Shtojca

► Tabela A.1. Vlerësimet e popullatës të punës së fëmijëve, sipas moshës dhe gjinisë

		Grupmosha			
		Fëmijët e moshës 5-11 vjeç	Fëmijët e moshës 12-14 vjeç	Fëmijët e moshës 15-17 vjeç	Gjithsej fëmijë 5-17 vjeç
Gjinia	Mashkull	7 698	4 175	519	12 212
	Femër	4 613	2 720		7 372

► Tabela A.2. Vëzhgimet e peshuara të punës së fëmijëve sipas moshës, gjinisë, vendbanimit, rajonit dhe kuintilit të indeksit të pasurisë, në përgjithësi në Kosovë

		Grupmosha			Gjithsej fëmijët 5-17 vjeç
		Fëmijët e moshës 5-11 vjeç	Fëmijët e moshës 12-14 vjeç	Fëmijët e moshës 15-17 vjeç	
Gjinia	Mashkull	128	57	7	193
	Femër	72	34	0	106
Vendbanimi	Urban	65	11	1	77
	Rural	136	80	6	222
Rajoni	Gjakovë	13	9	0	22
	Gjilan	22	14	1	37
	Mitrovicë	30	2	0	31
	Pejë	11	10	2	24
	Prizren	14	16	4	34
	Prishtinë	76	30	0	106
	Ferizaj	35	11	0	46
	Më i varfëri	67	41	5	113
	I dytë	39	25	1	65
Kuintili i indeksit të pasurisë	I mesëm	35	8	0	43
	I katërt	30	5	1	37
	Më i pasuri	29	12	0	41
<b>Gjithsej</b>	<b>201</b>	<b>92</b>	<b>7</b>	<b>299</b>	

► Tabela A.3. Vëzhgimet e peshuara të punës së fëmijëve sipas moshës, gjinisë, vendbanimit, rajonit dhe indeksit të pasurisë, komunitetet rom , egjiptian dhe ashkali

		Grupmosha			Gjithsej fëmijët 5-17 vjeç
		Fëmijët e moshës 5-11 vjeç	Fëmijët e moshës 12-14 vjeç	Fëmijët e moshës 15-17 vjeç	
<b>Gjinia</b>	Mashkull	55	16	24	96
	Femër	42	11	0	53
<b>Vendbanimi</b>	Urban	46	13	11	69
	Rural	51	15	13	80
<b>Kuintili i indeksit të pasurisë</b>	Më i varfëri	24	8	4	37
	I dytë	32	7	4	43
	I mesëm	11	6	6	23
	I katërt	10	2	10	22
	Më i pasuri	19	5	0	23
<b>Gjithsej</b>		<b>97</b>	<b>28</b>	<b>24</b>	<b>149</b>


► Tabela A.4. Statistikat përmbledhëse për variablat e përdorur në seksionin 4, në përgjithësi në Kosovë

Variabli	Mesatarja	Devijimi standard	Minimumi	Maksimumi
Puna e fëmijëve (SDG)	0.05	0.22	0	1
Mosha	11.21	3.80	5	17
Mosha <sup>2</sup>	140.09	84.70	25	289
Mashkull	0.52	0.50	0	1
Shqiptar	0.90	0.30	0	1
Rural	0.59	0.49	0	1
Madhësia e ekonomisë familjare	6.39	2.43	2	22
Jetim	0.03	0.16	0	1
Pa prind biologjik	0.07	0.26	0	1
Diferenca funksionale	0.10	0.30	0	1
Qasje në ujë	0.64	0.48	0	1
Kryefamiljari me arsim të lartë	0.19	0.39	0	1
<b>Kuintili i indeksit të pasurisë</b>				
I parë	0.26	0.44	0	1
I dytë	0.22	0.41	0	1
I mesëm	0.18	0.38	0	1
I katërt	0.17	0.38	0	1
Më i pasuri	0.17	0.38	0	1

► **Tabela A.5. Statistikat përmbledhëse për variablat e përdorur në seksionin 4, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**

Variabli	Mesatarja	Devijimi standard	Minimumi	Maksimumi
<b>Puna e fëmijëve (SDG)</b>	0.07	0.26	0	1
<b>Mosha</b>	10.92	3.92	5	17
<b>Mosha<sup>2</sup></b>	134.59	86.87	25	289
<b>Mashkull</b>	0.53	0.50	0	1
<b>Rural</b>	0.49	0.50	0	1
<b>Madhësia e ekonomisë familjare</b>	7.31	2.28	2	16
<b>Jetim</b>	0.04	0.20	0	1
<b>Pa prind biologjik</b>	0.08	0.27	0	1
<b>Diferenca funksionale</b>	0.16	0.36	0	1
<b>Qasje në ujë</b>	0.80	0.40	0	1
<b>Kuintili i Indeksit të pasurisë</b>				
<b>I parë</b>	0.23	0.42	0	1
<b>I dytë</b>	0.24	0.43	0	1
<b>I mesëm</b>	0.20	0.40	0	1
<b>I katërt</b>	0.20	0.40	0	1
<b>Më i pasuri</b>	0.14	0.34	0	1





**Fundamental Principles and Rights at  
Work Branch (FUNDAMENTALS)  
Governance and Tripartism Department  
(GOVERNANCE)**

**International Labour Office**

4 route des Morillons

CH-1211 Geneva 22 D Switzerland

T: +41 (0) 22 799 61 11

E: [childlabour@ilo.org](mailto:childlabour@ilo.org)

[ilo.org/childlabour](http://ilo.org/childlabour)

ISBN 978-92-2-038577-7



9 789220 385777